

**LIGJ**  
**Nr.10 077, datë 16.2.2009**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR LEJIMIN E  
PËRKOHSHËM, BËRË NË STAMBOLL MË 26 QERSHOR 1990**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën për lejimin e përkohshëm, bërë në Stamboll më 26 qershor 1990.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6079, datë 4.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**KONVENTA**  
**MBI LEJIMIN E PËRKOHSHËM**

(Stamboll, 26 qershor 1990)  
**PARATHËNIE**

Palët kontraktuese të kësaj Konvente, të krijuara nën kujdesin e Këshillit për Bashkëpunimin Doganor,

*duke vërejtur* se situata aktuale në lidhje me përhapjen dhe natyrën e shpërndarë të konventave ndërkombëtare doganore mbi lejimin e përkohshëm është e pakënaqshme;

*duke marrë në konsideratë* se situata mund të përkeqësohet në të ardhmen kur kategori të reja të lejimit të përkohshëm duhet të rregullohen ndërkombëtarisht;

*duke marrë parasysh* kërkesat e përfaqësuesve të tregut dhe palëve të tjera të interesuara, me qëllim lehtësimin e kryerjes së formaliteteve të lejimit të përkohshëm;

*duke konsideruar* se thjeshtëzimi dhe harmonizimi i procedurave doganore dhe, në veçanti, miratimi i një instrumenti të vetëm ndërkombëtar që të ndërthurë të gjitha konventat ekzistuese mbi lejimin e përkohshëm mund të lehtësojë aksesin për dispozitat ndërkombëtare që rregullojnë lejimin e përkohshëm dhe kontribuojnë me efektshmëri për zhvillimin e tregut ndërkombëtar dhe shkëmbimeve të tjera ndërkombëtare;

*të bindur* se një instrument ndërkombëtar, i cili propozon dispozita uniforme në lidhje me lejimin e përkohshëm, mund të sjellë përfitime thelbësore për shkëmbimet ndërkombëtare dhe mund të sigurojë një nivel të lartë të thjeshtëzimit dhe harmonizimit të procedurave doganore, i cili është një ndër qëllimet kryesore të Këshillit për Bashkëpunimin Doganor;

*të vendosura* për të lehtësuar lejimin e përkohshëm me anë të thjeshtëzimit dhe harmonizimit të procedurave, lidhur me objektivat ekonomike, humanitare, kulturore, sociale ose turistike;

*duke marrë parasysh* se miratimi i dokumenteve të pranimit të përkohshëm me një model të standardizuar si dokumente ndërkombëtare doganore me siguri ndërkombëtare kontribuon për lehtësimin e procedurës së lejimit të përkohshëm kur kërkohet një dokument dhe garanci doganore,

kane rënë dakord si më poshtë:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Përkufizimet**  
Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente, termi:

a) "lejimi i përkohshëm" do të thotë:

- procedura doganore, sipas së cilës mallra të caktuara (duke përfshirë mjetet e transportit) mund të hyjnë në një territor doganor, duke u përjashtuar me kusht nga tatimet dhe taksat e importit, dhe pa zbatuar ndalimet ose kufizimet e importit të natyrës ekonomike; këto mallra (duke përfshirë mjetet e transportit) mund të importohen për një qëllim specifik dhe duhet të jenë për qëllim rieksporimit brenda një periudhe të specifikuar dhe pa pësuar ndonjë ndryshim, përveç amortizimit normal për shkak të përdorimit të tyre;

b) "detyrimet dhe taksat e importit" nënkuptojnë:

- detyrimet doganore dhe të gjitha detyrimet, taksat, pagesat dhe detyrime të tjera që mblihen që vilen për importimin e mallrave ose në lidhje me to (duke përfshirë mjetet e transportit), por ku nuk përfshihen pagesa dhe detyrimet që kufizohen me shumën e kostos së përafërt të shërbimeve të kryera;

c) "garancia" do të thotë:

- sigurimi i plotësimi të një detyrimi doganor që kënaq kërkesat e doganës. Garancia përshkruhet si "e përgjithshme" kur siguron përmbushjen e detyrimeve që lindin nga disa operacione;

d) "dokumentet e lejimit të përkohshëm" do të thotë:

- dokumentin ndërkombëtar doganor të pranuar si deklaratë doganore, e cila bën të mundur identifikimin e mallrave (duke përfshirë edhe mjetet e transportit) dhe që përfshin një garanci të vlefshme ndërkombëtarisht për të mbuluar detyrimet dhe taksat e importit;

e) "bashkimi doganor ose ekonomik" do të thotë:

- një bashkim i themeluar dhe i përbërë nga anëtarët, siç përmenden në nenin 24, paragrafi 1 i kësaj Konvente, i cili ka kompetencën për të miratuar legjislacionin e tij që është i detyrueshëm për anëtarët e tij, në lidhje me çështjet e trajtuara nga kjo Konventë, dhe ka kompetencën të vendosë, në përputhje me procedurat e saj të brendshme, të nënshkruajë, të ratifikojë ose të pranojë anëtarë në këtë Konventë;

f) "person" do të thotë: person fizik dhe juridik, përjashtuar rasti kur konteksti e kërkon ndryshe;

g) "Këshill" do të thotë:

- organizata e themeluar nga Konventa duke krijuar një Këshill për Bashkëpunimin Doganor, në Bruksel, më 15 dhjetor 1950;

h) "ratifikim" do të thotë: ratifikimi, pranimi ose miratimi.

KREU II  
QËLLIMI I KONVENTËS

Neni 2

1. Secila prej palëve kontraktuese merr përsipër të japë lejimi të përkohshëm, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, për mallrat (duke përfshirë mjetet e transportit) e specifikuar në shtojcat e kësaj Konvente.

2. Pa paragjykuar dispozitat e shtojcës E, lejimi i përkohshëm duhet të jepet me përjashtimin total të kushtëzuar nga detyrimet dhe taksat doganore dhe pa zbatuar kufizimet ose ndalimet e një natyre

ekonomike.

### **Struktura e shtojcave**

Neni 3

Secila prej shtojcave të kësaj Konvente, në parim, konsiston në:

- a) perkufizimin e termave kryesorë doganorë të përdorur në shtojcë;
- b) dispozita të veçanta të zbatueshme për mallrat (duke përfshirë mjetet e transportit), të cilat përbëjnë objektin e shtojcave.

### **KREU III**

#### **DISPOZITA TË VEÇANTA**

#### **Dokumentë dhe garancia**

Neni 4

1. Përveç rastit kur parashikohet ndryshe në njërin nga shtojcat, secila palë kontraktuese ka të drejtë të kryejë lejimin e përkohshëm të mallrave (duke përfshirë mjetet e transportit) duke paraqitur një dokument doganor dhe duke mundësuar garancinë.

2. Kur kërkohet garancia (sipas paragrafit 1 më sipër), personat të cilët përdorin rregullisht procedurën e lejimit të përkohshëm, mund të autorizohen që të mundësojnë një garanci të përgjithshme.

3. Përveç rastit kur parashikohet ndryshe në njërin nga shtojcat, shuma e garancisë nuk duhet të tejkalojë shumën e detyrimeve dhe taksave të importit prej të cilave mallrat (duke përfshirë mjetet e transportit) përjashtohen me kusht.

4. Për mallrat (duke përfshirë mjetet e transportit) të cilat janë objekt i ndalimeve ose kufizimeve të importit sipas legjislacionit kombëtar, mund të kërkohet një garanci shtesë sipas dispozitave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar.

#### **Dokumentet e lejimit të përkohshëm**

Neni 5

Pa paragjykuar veprimet e lejimit të përkohshëm sipas dispozitave të shtojcës E, secila palë kontraktuese duhet të pranojë, në vend të dokumenteve të saj kombëtare doganore dhe si të nevojshme për sigurimin e shumave të referuara në nenin 8 të shtojcës A, dokumentet e lejimit të përkohshëm, të vlefshme për territorin e saj dhe të lëshuara dhe të përdorura në përputhje me kushtet e përcaktuara në atë shtojcë për mallrat (duke përfshirë mjetet e transportit) të importuara përkohësisht sipas shtojcave të tjera të kësaj Konvente, që ajo i ka pranuar.

#### **Identifikimi**

Neni 6

Secila palë kontraktuese mund të kryejë lejimin e përkohshëm të mallrave (duke përfshirë mjetet e transportit) me kusht që të jenë të identifikueshme kur përfundon lejimi i përkohshëm.

#### **Periudha e riekportimit**

Neni 7

1. Mallrat (duke përfshirë mjetet e transportit) të cilave u jepet lejimi i përkohshëm, do të riekportohen brenda një periudhe të dhënë, e konsideruar të mjaftueshme për të arritur qëllimin e lejimit të përkohshëm. Kjo periudhë është e përcaktuar veçmas në secilën shtojcë.

2. Organet doganore mund t'i japin një periudhë më të gjatë se ajo e parashikuar në secilën shtojcë, ose mund të zgjatën periudhën fillestare.

3. Kur mallrat që iu është dhënë lejimi i përkohshëm (duke përfshirë mjetet e transportit), nuk mund të kryejnë riekportimin e tyre si rezultat i konfiskimit që nuk është konfiskimi i kryer me padinë e

personave privat, kërkesa për riekспортim duhet të pezullohet për sa kohë zgjat konfiskimi.

### **Transferimi i regjimit të lejimit të përkohshëm**

Neni 8

Kur kërkohet, secila palë kontraktuese mund t'ia autorizojë transferimin e përfitimit të procedurës së lejimit të përkohshëm çdo personi tjetër, duke mundësuar që ky personi tjetër:

- a) të përmbushë kushtet e shprehura në këtë Konventë; dhe
- b) të pranojë detyrimet e përfituesit të parë të procedurës së lejimit të përkohshëm.

### **Përfundimi i lejimit të përkohshëm**

Neni 9

Lejimi i përkohshëm normalisht mbyllet nga riekспортimi i mallrave (duke përfshirë mjetet e transportit) që u është dhënë lejimi përkohshëm.

Neni 10

Mallrat përkohësisht të lejuara (duke përfshirë mjetet e transportit) mund të riekспортohen në një ose më shumë dërgesa.

Neni 11

Mallrat përkohësisht të lejuara (duke përfshirë mjetet e transportit) mund të riekспортohen nëpërmjet një zyre doganore tjetër veç asaj nëpërmjet së cilës u importuan.

### **Raste të tjera të mundshme përfundimi**

Neni 12

Lejimi i përkohshëm mund të përfundojë me marrëveshje të organeve kompetente, duke i vendosur mallrat (përfshirë mjetet e transportit) në një port të lirë ose zonë të lirë, në një magazinë doganore ose nën procedurat e tranzitit doganor, me synim eksportimin e tyre pasues ose disponime të tjera të autorizuara.

Neni 13

Lejimi i përkohshëm mund të përfundojë me anë të zhdoganimit për përdorim vendas, kur e justifikojnë rrethanat dhe e lejon legjislacioni kombëtar, duke iu nënshtuar kushteve dhe formaliteteve të cilat zbatohen në këto raste.

Neni 14

1. Lejimi i përkohshëm mund të përfundojë kur mallrat (duke përfshirë mjetet e transportit) janë dëmtuar seriozisht nga aksidenti ose nga një forcë madhore, dhe, siç mund të vendosin autoritetet doganore, ato:

a) u nënshtohen detyrimeve dhe taksave të importit, të cilat ishin të detyruar t'i paguanin në kohën kur u paraqitën në doganë në gjendjen e tyre të dëmtuar, me qëllim përfundimin e lejimit të përkohshëm;

b) të braktisur, të përjashtuara nga të gjitha shpenzimet, për autoritetet kompetente të territorit të lejimit të përkohshëm, në rastin kur personi që përfiton nga lejimi i përkohshëm duhet të jetë i përjashtuar nga të gjitha pagesat e detyrimeve dhe taksave të importit; ose

c) të shkatërruara, sipas mbikëqyrjes zyrtare, me shpenzimet e palëve të interesuara, çdo pjesë apo material i shpëtuar, nëse zhdoganohen për përdorim vendas do t'u nënshtohen detyrimeve dhe taksave të importit, të cilat janë të detyruara t'i paguajnë në kohën kur janë paraqitur dhe me kushtet që janë paraqitur në doganë pas aksidentit ose forcës madhore;

2. Lejimi i përkohshëm mund të përfundojë edhe kur, me kërkesën e personit të interesuar, mallrat (përfshirë mjetet e transportit) disponohen në njërin prej mënyrave të parashikuara në paragrafin 1 (b) ose (c) më sipër, siç mund të vendosin organet doganore.

3. Lejimi i përkohshëm, gjithashtu, mund të përfundojë me kërkesën e personit të interesuar kur ky person përmbush kriteret e organeve doganore lidhur me asgjësimin ose humbjen totale të mallrave (duke përfshirë mjetet e transportit) nga një aksident ose forcë madhore. Në këtë rast, personi që përfiton nga lejimi i përkohshëm do të përjashtohet nga pagesa e detyrimeve dhe taksave të importit.

#### KREU IV DISPOZITA TË NDRYSHME

##### **Reduktimi i formaliteteve** Neni 15

Secila palë kontraktuese duhet të reduktojë deri në minimum formalitetet doganore të kërkuara në lidhje me lehtësirat e parashikuara në këtë Konventë. Të gjitha rregulloret lidhur me këto formalitete duhet të botohen menjëherë.

##### **Autorizimet paraprake** Neni 16

1. Kur lejimi i përkohshëm i nënshtrohet autorizimit paraprak, kjo duhet të jepet nga zyra kompetente doganore sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Në raste të veçanta, kur kërkohet autorizimi jodoganor, kjo duhet të jepet sa më shpejt që të jetë e mundur.

##### **Lehtësira minimale** Neni 17

Dispozitat e kësaj Konvente përcaktojnë lehtësirat minimale që duhet të akordohen. Ato nuk e ndalojnë aplikimin e lehtësirave më të mëdha që palët kontraktuese japin ose mund të japin në të ardhmen me anë të dispozitave të njëanshme ose me anë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

##### **Bashkimet doganore ose ekonomike** Neni 18

1. Për qëllim të kësaj Konvente, territoret e palëve kontraktuese, të cilat përbëjnë një bashkim doganor ose ekonomik mund të konsiderohen një territor i vetëm.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk ndalon palët kontraktuese, të cilat përbëjnë një bashkim doganor ose ekonomik, të miratojnë dispozita të veçanta të zbatueshme për veprimet e lejimit të përkohshëm në territorin e këtij bashkimi, me kushtin që këto dispozita të mos i reduktojnë lehtësirat e parashikuara nga kjo Konventë.

##### **Ndalimet dhe kufizimet** Neni 19

Dispozitat e kësaj Konvente nuk përjashtojnë zbatimin e ndalimeve ose kufizimeve të vëna sipas ligjeve dhe rregulloreve kombëtare mbi bazën e konsideratave joekonomike, të tilla si: konsiderata të moralitetit ose rendit publik, sigurisë publike dhe higjienës ose shëndetit publik, konsideratave veterinare ose fitosanitare, konsideratat që lidhen me mbrojtjen e specieve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër dhe të gjallë, ose konsideratave që lidhen me mbrojtjen e së drejtës së autorit ose pronës industriale.

## **Shkeljet**

Neni 20

1. Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Konvente e bën shkelësin përgjegjës në territorin e palës kontraktuese ku u krye shkelja sipas sanksioneve të parashikuara nga legjislacioni i palës kontraktuese.

2. Kur nuk është e mundur të përcaktohet territori në të cilin ka ndodhur një parregullsi, do të merret sikur ka ndodhur në territorin e palës kontraktuese ku është zbuluar.

## **Shkëmbimi i informacionit**

Neni 21

Palët kontraktuese duhet t'i komunikojnë njëra-tjetrës, me kërkesë dhe deri në masën që lejon legjislacioni kombëtar, informacionin e nevojshëm për implementimin e dispozitave të kësaj Konvente.

## **KREU V**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Komiteti administrativ**

Neni 22

1. Një komitet administrativ duhet të krijohet me qëllim implementimin e kësaj Konvente, çdo masë për të siguruar njëtrajtshmërinë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Konvente dhe çdo ndryshim të propozuar për të. Komiteti administrativ duhet të vendosë në lidhje me përfshirjen e shtojcave të reja në këtë Konventë.

2. Palët kontraktuese duhet të jenë pjesëtarë të komitetit administrativ. Komiteti mund të vendos që administrata kompetente e çdo vendi anëtar, shteti ose territori doganor të përmendur në nenin 24 të kësaj Konvente, të cilët nuk janë palë kontraktuese, ose përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, për çështjet që u interesojnë, mund të marrin pjesë në sesionet e komitetit si vëzhgues.

3. Këshilli i siguron komitetit shërbime sekretarie.

4. Me rastin e çdo mbledhjeje, komiteti, zgjedh një kryetar dhe një zëvendëskryetar.

5. Administratat kompetente të palëve kontraktuese e njoftojnë këshillin lidhur me propozimet për ndryshimet e kësaj Konvente për to, së bashku me çdo kërkesë për përfshirjen e pikave në rendin e ditës e sesioneve të komitetit. Këshilli duhet t'ua bëjë të ditur administratave kompetente të palëve kontraktuese dhe të vendeve anëtare, shteteve ose territoreve doganore të përmendura në nenin 24 të kësaj Konvente të cilat nuk janë palë kontraktuese.

6. Këshilli e mbledh komitetin në një kohë të përcaktuar nga ai dhe gjithashtu, sipas kërkesës së administratave kompetente, të paktën të dy prej palëve kontraktuese. Projekti i rendit të ditës do të qarkullojë në administratat kompetente të palëve kontraktuese dhe të anëtarëve, shteteve ose territoreve doganore të përmendura në nenin 24 të kësaj Konvente të cilat nuk janë palë kontraktuese, të paktën gjashtë javë përpara mbledhjes së komitetit.

7. Sipas vendimit të komitetit, duke u mbështetur në dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, këshilli fton administratat kompetente të anëtarëve, shteteve ose territoreve doganore të përmendura në nenin 24 të kësaj Konvente, të cilat nuk janë palë kontraktuese, si dhe organizatat ndërkombëtare të interesuara për t'u përfaqësuar nga vëzhgues në sesionet e komitetit.

8. Propozimet duhet të hidhen në votim. Secila prej palëve kontraktuese e përfaqësuar në mbledhje ka të drejtën e një vote. Propozimet, përveç atyre për ndryshimet e kësaj Konvente, miratohen nga komiteti me shumicën e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Propozimet për ndryshimet e kësaj Konvente miratohen me dy të tretat e shumicës së anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

9. Kur zbatohet neni 24, paragrafi 7 i kësaj Konvente, bashkimet doganore ose ekonomike, palë në këtë Konventë, në rast votimi, do të kenë vetëm një numër votash të barabartë me totalin e votave të caktuara për anëtarët e tyre, që janë palët kontraktuese të kësaj Konvente.

10. Përpara mbylljes së sesionit, komiteti duhet të miratojë një raport.

11. Në mungesë të dispozitave përkatëse në këtë nen, rregullat e procedurës së këshillit zbatohen përjashtuar rastin kur komiteti vendos ndryshe.

## **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Neni 23

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë prej palëve kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, për aq sa është e mundur, duhet të zgjidhen me negociata midis tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje që nuk është zgjidhet me negociata, palët kontraktuese duhet t'ia referojnë komitetit administrativ, i cili e merr në konsideratë mosmarrëveshjen dhe bën rekomandimet përkatëse për zgjidhjen e saj.

3. Palët kontraktuese që kanë mosmarrëveshje, mund të bien dakord paraprakisht që të pranojnë rekomandimet e komitetit administrativ si detyruese.

## **Nënshkrimi, ratifikimi dhe miratimi**

Neni 24

1. Secili vend anëtar i këshillit dhe secili vend anëtar i Kombeve të Bashkuara, apo agjencitë e tyre të specializuara, mund të bëhen palë kontraktuese në këtë Konventë :

- a) duke e nënshkruar atë pa rezerva për ratifikimin;
- b) duke depozituar një instrument të ratifikimit pasi është nënshkruar si objekt ratifikimi; ose
- c) duke u bërë anëtar i saj.

2. Konventa është e hapur për nënshkrim nga vendet anëtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, ose gjatë sesioneve të këshillit ku mund të miratohet, ose më pas në zyrat qendrore të këshillit në Bruksel deri në 30 qershor 1991. Pas kësaj date, ajo do të jetë e hapur për të pranuar këta anëtarë.

3. Secili shtet ose qeveri e secilit prej territorit të veçuar doganor që propozohet nga një palë kontraktuese si përgjegjës për kryerjen zyrtare të marrëdhënieve diplomatike, por që është autonom në kryerjen e marrëdhënieve tregtare, duke mos qenë anëtar i organizatave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, të cilit i është dërguar një ftesë për këtë qëllim nga depozituesi me kërkesë të së komitetit administrativ, mund të bëhet palë kontraktuese në këtë Konvente duke u futur në të pasi ajo të hyjë në fuqi.

4. Secili prej vendeve anëtare, shteteve apo territorit doganor, të përmendura në paragrafin 1 ose 3 të këtij neni, kur nënshkruan pa rezerva për ratifikimin, kur e ratifikon ose bëhet pjesë e kësaj Konvente, duhet të specifikojë shtojcat që pranon, duke qenë e domosdoshme që të pranojë shtojcën A dhe të paktën një prej shtojcave të tjera. Më pas duhet të njoftojë depozituesin që pranon një apo më shumë shtojca.

5. Palët kontraktuese që pranojnë ndonjë shtojcë të re të cilën komiteti administrativ ka vendosur ta përfshijë në këtë Konventë, duhet të njoftojë depozituesin, në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.

6. Palët kontraktuese duhet të njoftojnë depozituesin për kushtet e aplikimit ose informacionin e kërkuar sipas nenit 8 dhe nenit 24, paragrafi 7 i kësaj Konvente; shtojca A, neni 2, paragrafët 2 dhe 3, shtojca E, neni 4. Gjithashtu, duhet të njoftojnë çdo ndryshim në zbatimin e këtyre dispozitave.

7. Secili bashkim doganor ose ekonomik, në përputhjeje me paragrafët 1, 2 dhe 4 të këtij neni, mund të bëhet palë kontraktuese e kësaj Konvente. Ky bashkim doganor ose ekonomik duhet të njoftojë depozituesin për kompetencat e tij lidhur me çështjet që rregullon kjo Konventë. Bashkimi doganor ose ekonomik i cili është një palë kontraktuese e kësaj Konvente, që brenda çështjeve që ka në kompetencën e tij, duhet të ushtrojë në emër të tij të drejtat dhe të përmbushë përgjegjësitë, të cilat kjo Konventë u ka akorduar anëtarëve të saj që janë palët kontraktuese të kësaj Konvente. Në këtë rast, anëtarëve nuk duhet t'u jepet e drejta që t'i ushtrojnë individualisht këto të drejta, duke përfshirë të drejtën e votës.

## **Depozituesi**

Neni 25

1. Kjo Konventë, me të gjitha nënshkrimet, me ose pa rezerva për ratifikimin dhe të gjitha instrumentet e ratifikimit ose të pranimit, duhet të depozitohet në Sekretarinë e Përgjithshme të Këshillit.

2. Depozituesi:

- a) duhet të marrë dhe të ruajë tekstet origjinale të kësaj Konvente;
- b) duhet të përgatitë kopjet e njësuara me tekstin origjinal të kësaj Konvente dhe t'i shpërndajë ato tek anëtarët dhe bashkimet doganore ose ekonomike të përmendura në nenin 24, paragrafët 1 dhe 7, të kësaj Konvente;

c) duhet të pranojë çdo nënshkrim, me ose pa rezerva, për ratifikimin, ratifikimin ose hyrjen në këtë Konventë dhe të marrë dhe të kujdeset për çdo instrument, njoftim dhe komunikim lidhur me të;

d) duhet të vëzhgojë nëse nënshkrimi ose çdo instrument, njoftim ose komunikim lidhur me këtë Konventë është në një formë të përshtatshme dhe të duhur dhe, nëse është e nevojshme, të sjellë çështjen në vëmendje të palës kontraktuese në fjalë;

e) duhet të njoftojë palët kontraktuese të kësaj Konvente, nënshkruesit e tjerë, anëtarët e këshillit të cilët nuk janë palë kontraktuese të kësaj Konvente dhe Sekretarin e Përgjithshëm Qendror të Kombeve të Bashkuara lidhur me:

- nënshkrimet, ratifikimet, hyrjet dhe pranimet e shtojcave sipas nenit 24 të kësaj Konvente;
- shtojcat e reja të cilat komiteti administrativ vendos t'i përfshijë në këtë Konventë;
- datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe të secilës shtojcë në përputhje me nenin 26 të kësaj Konvente;
- njoftimet e marra në përputhje me nenin 24, 29, 30 dhe 32 të kësaj Konvente;
- denoncimet sipas nenit 31 të kësaj Konvente;

- çdo ndryshim që konsiderohet se është pranuar në përputhje me nenin 32 të kësaj Konvente, si dhe data e hyrjes së saj në fuqi.

3. Kur shfaqen dallime midis një pale kontraktuese dhe depozituesit lidhur me kryerjen e funksioneve të këtij të fundit, depozituesi ose pala kontraktuese duhet ta sjellë çështjen në vëmendje të palëve të tjera kontraktuese dhe të nënshkruesve, ose të këshillit, kur duhet.

### **Hyrja në fuqi**

#### **Neni 26**

1. Kjo Konventë hyn në fuqi tre muaj pasi pesë vendet anëtare ose bashkimet doganore dhe ekonomike, të përmendura në nenin 24, paragrafët 1 dhe 7 të kësaj Konvente, e kanë nënshkruar këtë Konventë për ratifikimin ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit.

2. Për secilën prej palëve kontraktuese që nënshkruan pa rezerva për ratifikimin, që e ratifikon ose aderon në këtë Konventë, pasi pesë vendet anëtare ose bashkimet doganore ose ekonomike e kanë nënshkruar atë pa rezerva për ratifikimin ose kanë depozituar instrumentet e tyre lidhur me ratifikimin ose aderimin, kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pasi pala kontraktuese në fjalë ta ketë nënshkruar atë pa rezerva për ratifikimin ose të ketë depozituar instrumentin e saj të ratifikimit ose aderimit.

3. Çdo shtojcë e kësaj Konvente do të hyjë në fuqi tre muaj pasi pesë vende anëtare ose bashkimet doganore ose ekonomike ta kenë pranuar këtë shtojcë.

4. Për çdo palë kontraktuese që pranon një shtojcë pasi ta kenë pranuar atë pesë vendet anëtare ose bashkimet doganore ose ekonomike, kjo shtojcë do të hyjë në fuqi tre muaj pasi pala kontraktuese në fjalë të këtë njoftuar pranimin e saj. Gjithsesi, asnjë shtojcë, nuk do të hyjë në fuqi për palën kontraktuese para se kjo Konventë të ketë hyrë në fuqi për atë palë kontraktuese.

### **Dispozita shfuqizuese**

#### **Neni 27**

Pas hyrjes në fuqi të një shtojce të kësaj Konvente që përmban një dispozitë shfuqizuese, kjo shtojcë do të shfuqizohet dhe do të zëvendësojë konventat ose dispozitat e konventave që i nënshtrohen dispozitës shfuqizuese, në marrëdhëniet mes palëve kontraktuese që e kanë pranuar atë shtojcë dhe që janë palët kontraktuese të këtyre konventave.

### **Konventa dhe shtojcat**

#### **Neni 28**

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, çdo shtojcë, që detyron një palë kontraktuese, do të konceptohet si pjesë integrale e kësaj Konvente, dhe në lidhje me atë palë kontraktuese, çdo referim në këtë Konventë do të gjykohet se përfshin referimin e këtyre shtojcave.

2. Për arsye votimi në komitetin administrativ, çdo shtojcë do të merret si një konventë më vete.

### **Rezervat**

#### **Neni 29**



1. Secila palë kontraktuese që pranon një shtojcë, do të gjykohet se i pranon të gjitha dispozitat e saj, vetëm nëse në kohën e miratimit të shtojcës ose në një moment të mëvonshëm njofton depozituesin për dispozitat për të cilat shpreh rezervat, kur kjo mundësi parashikohet në shtojcën në fjalë, duke deklaruar ndryshimet që ekzistojnë midis dispozitave të legjislacionit kombëtar dhe dispozitave në fjalë.

2. Secila palë kontraktuese duhet që të paktën një herë në pesë vjet të rishikojë dispozitat për të cilat ka shprehur rezerva, duke i krahasuar me dispozitat e legjislacionit kombëtar dhe të njoftojë depozituesin për rezultatet e këtij rishikimi.

3. Secila prej palëve kontraktuese që ka shprehur rezerva mund t'i tërheqë ato, tërësisht ose pjesërisht në çdo kohë, duke njoftuar depozituesin dhe saktësuar datën kur kjo tërheqje do të hyjë në fuqi.

### **Zgjerimi territorial**

Neni 30

1. Secila palë kontraktuese, në momentin e nënshkrimit të kësaj Konvente pa rezerva për ratifikimin ose depozitim të instrumenteve për ratifikimin ose aderimin, ose në një moment tjetër të mëvonshëm, mund të deklarojë duke njoftuar depozituesin se kjo Konventë do të shtrihet në të gjitha ose ndonjë prej territoreve për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave përgjigjet. Ky njoftim do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së marrjes nga depozituesi. Megjithatë, kjo Konventë nuk zbatohet për territoret të emëruara në njoftim përpara se kjo Konventë të hyjë në fuqi për palët kontraktuese në fjalë.

2. Çdo palë kontraktuese që ka bërë një njoftim sipas paragrafit 1 të këtij neni duke zgjeruar këtë Konventë me ndonjë territor, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit përgjigjet, mund ta njoftojë depozituesin, sipas procedurës së nenit 31 të kësaj Konvente, se territori në fjalë nuk do ta zbatojë më këtë Konventë.

### **Denoncimi**

Neni 31

1. Kjo Konventë ka një kohëzgjatje të pakufizuar, por secila palë kontraktuese mund të bëjë denoncim për të në çdo kohë pas datës së hyrjes në fuqi sipas nenit 26 të kësaj Konvente.

2. Denoncimi duhet të njoftohet me anë të një instrumenti me shkrim, e depozituar tek depozituesi.

3. Denoncimi hyn në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së instrumentit të denoncimit nga depozituesi.

4. Dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni duhet të zbatohen gjithashtu lidhur me shtojcat e kësaj Konvente, duke pasur çdo palë kontraktuese të drejtën që në çdo kohë pas datës së hyrjes së tyre në fuqi, sipas nenit 26 të kësaj Konvente, të tërheqë pranimin e saj për një ose më shumë shtojcave. Secila prej palëve kontraktuese që të tërheqë pranimin e saj e të gjitha shtojcave do të konsiderohet se e ka kallëzuar Konventën. Gjithashtu, një palë kontraktuese që tërheq pranimin e shtojcës A, edhe pse vazhdon të pranojë shtojcat e tjera, do të konsiderohet se e ka kallëzuar këtë Konventë.

### **Procedura e amendimit**

Neni 32

1. Komiteti administrativ, i mbledhur në përputhje me nenin 22 të kësaj Konvente, mund të rekomandojë amendimet e kësaj Konvente dhe të shtojcave të saj.

2. Teksti i çdo amendimi të rekomanduar duhet t'i komunikohet nga depozituesi të gjitha palëve kontraktuese të kësaj Konvente, nënshkruesve të tjerë dhe atyre vendeve anëtare të këshillit, të cilat nuk janë palë kontraktuese të kësaj Konvente.

3. Çdo amendim i rekomanduar i komunikuar në përputhje me paragrafin paraprirës do të hyjë në fuqi për sa i përket të gjitha palëve kontraktuese, gjashtë muaj pas mbarimit të afatit prej dymbëdhjetë muajsh pas datës së komunikimit të amendimit të rekomanduar, nëse nuk janë njoftuar kundërshtime lidhur me amendimet e rekomanduara gjatë kësaj periudhe për depozituesin nga pala kontraktuese.

4. Nëse një kundërshtim lidhur me amendimin e rekomanduar i është njoftuar depozituesit nga pala kontraktuese përpara skadimit të periudhës prej dymbëdhjetë muajsh, e specifikuar në paragrafin 3 të këtij neni, amendimi do të konsiderohet i pamiratur dhe sidoqoftë nuk do të ketë fuqi.

5. Për qëllimin e njoftimit të një kundërshtimi, çdo shtojcë do të konsiderohet një Konventë më vete.

## **Pranimi i amendimeve**

Neni 33

1. Çdo palë kontraktuese që e ratifikon këtë Konventë, ose aderon në të do të konsiderohet se e ka pranuar çdo amendament të saj që ka hyrë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit ose aderimit.

2. Çdo palë kontraktuese që pranon një shtojcë, do të konsiderohet se ka pranuar çdo amendim të asaj shtojce që ka hyrë në fuqi në datën në të cilën ajo i njofton depozituesit pranimin e saj, me përjashtim të rastit kur ajo paraqet rezerva, sipas nenit 29 të kësaj Konvente .

## **Regjistrimi dhe tekstet autentike**

Neni 34

Në përputhje me nenin 102 të Kartës të Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë do të regjistrohet në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara me kërkesën e depozituesit.

Kjo Konventë është nënshkruar duke dëshmuar sa më sipër, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë, e kanë nënshkruar këtë Konventë.

E hartuar në Stamboll, më njëzet e gjashtë qershor, një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, në një origjinal, në gjuhën angleze dhe frënge, duke qenë të dyja tekstet njësoj autentike. Depozituesit i kërkohet të përgatitë dhe të qarkullojë përkthimet e autorizuara të kësaj Konvente në gjuhët arabe, kineze, ruse dhe spanjolle.

### **SHTOJCA A**

#### **SHTOJCË PËR DOKUMENTET E LEJIMIT TË PËRKOHSHËM (CARNET ATA DHE CARNET CPD)**

### **KREU I**

#### **Përkufizime**

Neni 1

Për qëllimet e kësaj shtojce, termi:

- a) "dokumente të lejimit të përkohshëm" do të thotë:
  - dokumenti ndërkombëtar doganor i pranuar si deklaratë doganore që bën të mundur identifikimin e mallrave (duke përfshirë mjetet e transportit) dhe që përfshin një garanci të vlefshme ndërkombëtare për të mbuluar detyrimet dhe taksat e importit;
- b) "Carnet ATA" do të thotë:
  - dokumentet e lejimit të përkohshëm, që përdoren për lejimin e përkohshëm të mallrave, duke përfshirë mjetet e transportit;
- c) "Carnet CPD" do të thotë:
  - dokumentet e lejimit të përkohshëm, që përdoren për lejimin e përkohshëm të mjeteve të transportit;
- d) "zinxhiri garantues" do të thotë:
  - një skemë garancie e administruar nga një organizatë ndërkombëtare, ku bëjnë pjesë shoqatat e garancive;
- e) "organizatë ndërkombëtare" do të thotë:
  - një organizatë ku bëjnë pjesë shoqata ndërkombëtare të autorizuara për garantimin dhe lëshimin e dokumenteve të lejimit të përkohshëm;
- f) "shoqatë garantuese" do të thotë:
  - një shoqata e miratuar nga organet doganore të një pale kontraktuese për të garantuar shumat e referuara në nenin 8 të kësaj shtojce në territorin e kësaj pale kontraktuese dhe që bën pjesë në një zinxhir garantues;
- g) "shoqata lëshuese" do të thotë:
  - shoqatën e miratuar nga organet doganore për të lëshuar dokumentet e lejimit të përkohshëm dhe që bën pjesë direkt dhe indirekt në zinxhirin e garancisë;
- h) "shoqatë homologe lëshuese" do të thotë:

- një shoqatë lëshuese e themeluar në një palë tjetër kontraktuese dhe që bën pjesë në të njëjtin zinxhir garancie;

i) "tranzit doganor" do të thotë:

- procedurë doganore, sipas së cilës mallrat transportohen nën kontrollin doganor nga njëra degë doganore në tjetrën.

## KREU II

### Qëllimi

#### Neni 2

1. Në përputhje me nenin 5 të kësaj Konventë, secila palë kontraktuese duhet të pranojë në vend të dokumenteve kombëtare doganore, dhe si garanci e rregullt e shumave të referuara në nenin 8 të kësaj shtojce, dokumentet e lejitimit të përkohshëm të vlefshme për territorin e kësaj pale kontraktuese, si dhe të lëshura dhe të përdorura në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë shtojcë për mallrat (përfshirë mjetet e transportit), të importuara përkohësisht sipas shtojcave të tjera të kësaj Konvente që ajo i ka pranuar.

2. Çdo palë kontraktuese mundet gjithashtu të pranojë dokumentet e lejitimit të përkohshëm, të lëshuara dhe të përdorura sipas të njëjtave kushte, për operacionet e regjimit të lejitimit të përkohshëm sipas ligjeve dhe rregulloreve kombëtare.

3. Çdo palë kontraktuese mund të pranojë dokumentet e lejitimit të përkohshëm për transitin doganor, të lëshuara dhe të përdorura sipas të njëjtave kushte.

4. Mallrat (përfshirë mjetet e transportit), me qëllim përpunimin dhe riparimin, nuk importohen të mbuluara nga dokumentet e lejitimit të përkohshëm.

#### Neni 3

1. Dokumentet e lejitimit të përkohshëm duhet t'u korrespondojnë modeleve të përcaktuara në shtesat e kësaj shtojce: shtesa I për shtojcën ATA, shtesa II për *carnet* CPD.

2. Shtesat e kësaj shtojce do të interpretohen si pjesë integrale e shtojcës.

## KREU III

### Garancia dhe lëshimi i dokumenteve të lejitimit të përkohshëm

#### Neni 4

1. Kundrejt kushteve dhe garancive të përcaktuara nga çdo palë kontraktuese, ajo mund të autorizojë shoqatat garantuuese të veprojnë si garantues dhe të lëshojnë dokumentet e lejitimit të përkohshëm, ose direkt ose nëpërmjet shoqatave lëshuese.

2. Një shoqatë garancie nuk duhet të miratohet nga asnjë palë kontraktuese po qe se garancia nuk mbulon detyrimet e shkaktuara në atë palë kontraktuese lidhur me operacionet që mbulojnë dokumentet e lejitimit të përkohshëm lëshuar prej shoqatave homologe lëshuese.

#### Neni 5

1. Shoqatat lëshuese nuk mund të lëshojnë dokumentet e lejitimit të përkohshëm brenda një periudhe vlefshmërie që kalon një vit nga data e lëshimit.

2. Të dhënat e veçanta të shënuara në dokumentet e lejitimit të përkohshëm nga shoqata lëshuese mund të ndryshohen vetëm me miratimin e shoqatës lëshuese ose garantuuese. Asnjë ndryshim nuk duhet t'u bëhet këtyre dokumenteve pasi ato të jenë pranuar nga organet doganore të territorit të lejitimit të përkohshëm, përfshirë kur këto organe japin pëlqimin.

3. Pasi është lëshuar *carnet* ATA, asnjë njësi shtesë nuk duhet t'i shtohet listës së mallrave të renditura në anën e pasme të kapakut ballor të *carnet*-it, ose në ndonjë prej fletëve vijuese të bashkangjitura aty (lista e përgjithshme).

## Neni 6

Të dhënat e veçanta më poshtë duhet të shënohen në dokumentet e lejimit të përkohshëm:

- emrin e shoqatës që lëshon *carnet*-in;
- emrin e zinxhirit garantues ndërkombëtar;
- vendet ose territoret doganore ku janë të vlefshme dokumentet e lejimit të përkohshëm; dhe
- emrat e shoqatave të garancive të vendeve ose territoreve doganore në fjalë.

## Neni 7

Periudha e fiksuar për rieksporimin e mallrave (përfshirë mjetet e transportit) të importuara me mbulimin e dokumenteve të lejimit të përkohshëm në asnjë rast nuk duhet ta kalojë periudhën e vlefshmërisë së atyre dokumenteve.

## KREU IV

### Garancia

#### Neni 8

1. Secila shoqatë e garancive duhet të ndërmarrë që t'i paguajë organeve doganore të palës kontraktuese në territorin ku është themeluar sasinë e detyrimeve dhe taksave të importit dhe të çdo shume tjetër, duke përjashtuar ato që përmenden në nenin 4, paragrafi 4 të kësaj Konvente, që paguhen në rast moszbatimi të kushteve të lejimit të përkohshëm, ose të transitit doganor, për sa u përket mallrave (përfshirë mjetet e transportit) që janë futur në atë territor të mbuluara nga dokumentet e lejimit të përkohshëm të lëshuar nga një shoqatë homologe lëshuese. Shoqata do të përgjigjet bashkërisht ose veç e veç me peronat, prej të cilëve duhen paguar shumat e mësipërme, për pagimin e këtyre shumave.

#### 2. *Carnet*-i ATA:

Detyrimet e shoqatës së garancisë nuk duhet të kalojnë shumën e detyrimeve dhe taksave të importit më shumë së dhjetë për qind.

#### *Carnet* CPD:

Shoqatës së garancisë nuk i kërkohet të paguajë një shumë më të madhe se totali i shumës së detyrimeve dhe taksave të importit, së bashku me interesat nëse aplikohen.

3. Kur organet doganore në territorin e lejimit të përkohshëm kanë mbyllur në mënyrë të pakushtëzuar dokumentet e lejimit të përkohshëm për disa mallra (përfshirë mjetet e transportit), ata nuk mund të kërkojnë nga shoqata e garancisë pagesën e shumave të referuara në paragrafin 1 të këtij neni në lidhje me këto mallra (përfshirë mjetet e transportit). Sidoqoftë, pretendimi mund të ngrihet kundër një shoqate të garancisë nëse zbulohet më pas se mbyllja e dokumenteve ishte kryer në mënyrë të pasaktë ose të pandershme, ose kur ka pasur shkelje të kushteve të lejimit të përkohshëm ose të transitit doganor.

#### 4. *Carnet* ATA:

Organet doganore nuk duhet të kërkojnë në asnjë rrethanë nga shoqata e garancisë pagesën e shumave të referuara në paragrafin 1 të këtij neni nëse nuk është ngritur pretendimi kundër shoqatës së garancisë brenda një viti nga data e skadimit të vlefshmërisë së *carnet*-it ATA.

#### 2. *Carnet* CPD :

Organet Doganore nuk duhet të kërkojnë në asnjë rrethanë nga shoqata e garancisë pagesën e shumave të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëse njoftimi për mosmbylljen e *carnet* CPD-së nuk është bërë për shoqatën e garancisë brenda një viti nga data e skadimit të vlefshmërisë së *carnet*. Për më tepër, organet doganore do t'i mundësojnë shoqatës së garancisë detaje të llogaritjes së detyrimeve dhe tatimeve të importit për një vit nga njoftimi i mosmbylljes së *carnet*-it CPD. Detyrimet e shoqatës së garancisë për këto shuma do të ndërpriten nëse ky informacion nuk jepet brenda periudhës së një viti.

## KREU V

### Rregullimi i dokumenteve të lejimit të përkohshëm

#### Neni 9

#### 1. *Carnet* ATA:

a) Shoqata e garancive do të ketë një periudhë kohe prej gjashtë muajsh nga data e ngritjes së

pretendimit të organeve doganore për shumat e përmendura në nenin 8, paragrafi 1 i kësaj shtojce, gjatë së cilës do të paraqesë prova të rieksporimit sipas kushteve të përcaktuara në këtë shtojcë ose në ndonjë anulim tjetër të rregullt të *carnet-it* ATA.

b) Nëse këto prova nuk sigurohen brenda kohës së lejuar, shoqata e garancive si rrjedhojë duhet të menjëherë të depozitohet ose t'i paguajë provizorisht këto shumat. Kjo depozitë ose pagesë do të finalizohet pas periudhës prej tre muajsh nga data e depozitimit ose pagesës. Gjatë periudhës së mëvonshme, shoqata e garancisë mund t'i paraqesë akoma provat e përmendura në nënparagrafin (a) të këtij paragrafi me synimin për të kthyer shumat e depozituara ose të paguara.

c) Për palët kontraktuese, për të cilat ligjet dhe rregulloret nuk parashikojnë depozita ose pagesa të përkohshme të detyrimeve dhe taksave të importit, pagesat e kryera në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (b) të këtij paragrafi do të konsiderohen si përfundimtare, ndërsa shumat e paguara do të kthehen nëse provat e përmendura në nënparagrafin (a) të këtij paragrafi paraqiten brenda tre muajve nga data e pagesës.

## 2. Carnet CPD:

a) Shoqatës së garancive i lejohet një periudhë prej një viti nga data e njoftimit për mosanulimin e *carne-it* CPD, në të cilën të paraqesë prova të rieksporimit sipas kushteve të përcaktuara në këtë shtojcë ose në ndonjë anulim tjetër të *carnet-it* CPD. Megjithatë, kjo periudhë mund të hyjë në fuqi vetëm në datën e skadimit të *carnet-it* CPD. Nëse organet doganore kundërshtojnë vlefshmërinë e provës së paraqitur, ato duhet të njoftojnë shoqatën e garancive brenda një periudhe që nuk i kalon 12 muaj.

b) Nëse kjo provë nuk paraqitet brenda kohës së lejuar, shoqata e garancive do të depozitohet ose do të depozitohet menjëherë, ose do të paguajë përkohësisht detyrimet dhe taksat pagueshme të importit brenda një periudhe maksimale prej tre muajsh. Kjo depozitë ose pagesë do të finalizohet pas një periudhe njëvjeçare nga dita e depozitimit ose pagesës. Më vonë, shoqata e garancive mundet sërish të sigurojë provën e përmendur në nënparagrafin (a) të këtij paragrafi me synim kthimin e shumave të depozituara ose të paguara.

c) Për palët kontraktuese, për të cilat ligjet dhe rregulloret nuk parashikojnë depozitat dhe pagesat e përkohshme të detyrimeve dhe taksave të importit, pagesat e kryera në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (b) të këtij paragrafi do të konsiderohen si përfundimtare, ndërsa shumat e paguara do të kthehen nëse provat e përmendura në nënparagrafin (a) të këtij paragrafi paraqiten brenda një viti nga data e pagesës.

## Neni 10

1. Provat për rieksporimin e mallrave (përfshirë edhe mjetet e transportit) të importuara sipas mbulimit nga dokumentet e lejimit të përkohshëm, do të jepen me kuponin e kontrollit të rieksporimit, të plotësuar dhe vulosur nga organet doganore në territorin e lejimit të përkohshëm.

2. Nëse rieksporimi nuk është certifikuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, organet doganore të territorit të lejimit të përkohshëm, edhe nëse periudha e vlefshmërisë së dokumenteve ka përfunduar, mund të pranojnë si provë për rieksporimin:

a) të dhënat e veçanta të regjistruara në organet doganore ose në ndonjë prej palëve të tjera kontraktuese në dokumentet e lejimit të përkohshëm mbi importimin ose rieksporimin, ose me anë të një certifikate të lëshuar nga këto organe të mbështetur në të dhënat e veçanta të paraqitura në kuponin e shkëputur nga dokumentet e importimit dhe riimportimit e cila provohet të ketë ndodhur pas rieksporimit të kryer, që ajo synon të sqarojë;

b) çdo provë tjetër dokumentare, e cila vërteton se mallrat (përfshirë mjetet e transportit) janë jashtë këtij territori.

2. Në çdo rast kur organet doganore të Palës Kontraktuese heqin dorë nga kërkesa për rieksporim të mallrave të caktuara (përfshirë mjetet e transportit) të lejuara në territorin e tyre sipas dokumenteve të lejimit të përkohshëm, shoqata e garancive do të shkarkohet nga detyrimet vetëm kur këto organe të kenë të vërtetuar me dokumente se është rregulluar pozicioni lidhur me këto mallra (përfshirë mjetet e transportit).

## Neni 11

Në rastet e përmendura në nenin 10, paragrafi 2 i kësaj shtojce, organet doganore kanë të drejtën të kërkojnë një pagesë rregulluese.

## KREU VI

### Dispozita të ndryshme

#### Neni 12

Vërtetimi doganor lidhur me dokumentet e lejimit të përkohshëm të përdorura sipas kushteve të përcaktuara në këtë shtojcë nuk do të kërkojë pagesë për përkujdesjen doganore në zyrat e doganës gjatë orëve normale të punës.

#### Neni 13

Në rastin e shkatërrimit, humbjes ose grabitjes së dokumenteve të lejimit të përkohshëm, ndërsa mallrat (përfshirë mjetet e transportit) që u referohen janë në territorin e ndonjëres palë kontraktuese, organet doganore të kësaj pale kontraktuese, me kërkesë të shoqatës lëshuese dhe sipas kushteve të parashkruara nga këto organe, duhet të pranojnë dokumentet zëvendësuese, vlefshmëria e të cilave përfundon në të njëjtën datë më afatin e dokumenteve që ato zëvendësojnë.

#### Neni 14

1. Në rastin kur pritet që operacioni i lejimit të përkohshëm do ta kalojë periudhën e vlefshmërisë së dokumenteve të lejimit të përkohshëm për shkak të pamundësisë së mbajtësit për të rieksporuar mallrat (përfshirë mjetet e transportit) brenda asaj periudhe, shoqata që lëshoi dokumentet mund të lëshojë dokumente zëvendësuese. Këto dokumente i paraqiten organeve doganore të palës kontraktuese të interesuar për kontrollin. Kur pranojnë dokumentet zëvendësuese, organet doganore në fjalë do të anulojnë dokumentet e zëvendësuara.

2. Vlefshmëria e *carnet*-eve CPD mundet të shtyhet vetëm njëherë për jo më shumë se një vit. Pas kësaj periudhe, një *carnet* i ri duhet të lëshohet për të zëvendësuar *carnet*-in e mëparshëm, si dhe duhet të pranohet nga organet doganore.

#### Neni 15

Kur zbatohet neni 7, paragrafi 3, i kësaj Konvente, organet doganore, kur është e mundur, njoftojnë shoqatën e garancive lidhur me konfiskimet e kryera nga ato, ose në emër të tyre, për mallrat (përfshirë mjetet e transportit) e pranuar sipas dokumenteve të lejimit të përkohshëm të garantuara nga ajo shoqatë, si dhe e njofton për masat që synojnë të ndërmarrin.

#### Neni 16

Në rastin e mashtrimit, kundërvënies ose abuzimit, pala kontraktuese, pavarësisht dispozitave të kësaj shtojce, është e lirë të marrë masa kundër personave të cilët përdorin dokumentet e lejimit të përkohshëm, për vjeljen e detyrimeve dhe taksave të importit dhe shumave të tjera të pagueshme, si dhe vendosjen e çdo penalteti për të cilat këta persona i detyrohen. Në këto raste shoqatat duhet t'i japin ndihmesën e tyre organeve doganore.

#### Neni 17

Dokumentet e lejimit të përkohshëm ose pjesë të tyre, të cilat janë lëshuar ose kanë për qëllim të lëshohen në territorin në të cilin ato janë importuar dhe të cilat i janë dërguar një shoqate lëshuese nga një shoqatë e garancive, nga një organizatë ndërkombëtare ose nga organet doganore të palës kontraktuese, përjashtohen nga detyrimet dhe taksat e importit, si dhe përjashtohen nga çdo ndalim ose kufizim importi. Lehtësirat përkatëse mundësohen gjatë eksportimit.

#### Neni 18

1. Secila palë kontraktuese ka të drejtën e regjistrimit të rezervave, në përputhje me nenin 29 të kësaj Konvente, lidhur me miratimin e *carnet*-eve ATA për trafikun postar.

2. Nuk lejohet asnjë rezervë tjetër për këtë shtojcë.

## Neni 19

1. Pasi të hyjë në fuqi kjo shtojcë, në përputhje me nenin 27 të kësaj Konvente, do të shfuqizojë dhe do të zëvendësojë Konventën doganore lidhur me *carnet* ATA për lejimin e përkohshëm të mallrave, Bruksel, 6 dhjetor 1961, (Konventa ATA), në marrëdhëniet mes palëve kontraktuese të cilat e kanë miratuar këtë shtojcë dhe të cilat janë palët kontraktuese të kësaj Konvente.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, *carnet*-et ATA që janë lëshuar në përputhje me termat e Konventës ATA përpara hyrjes në fuqi të kësaj shtojce, do të miratohen në momentin e përbushjes së operacioneve për të cilat janë lëshuar.

### Shtesa II për shtojcën A - Modeli carnet CPD

#### SHTOJCA B.1

#### SHTOJCË

LIDHUR ME MALLRAT PER T'U SHFAQUR OSE PËRDORUR NËPËR EKSPOZITA, PANAIRE, MBLEDHJE OSE NJGJARJE TË NGJASHME

#### KREU I

#### Përkufizimi

##### Neni 1

Për arsye të kësaj shtojce, termi “ngjarje” do të thotë:

1. ekspozitë, panair ose shfaqje të ngjashme me karakter tregtar, industrial, bujqësor ose artizanal;
2. ekspozitë ose takim kryesisht i organizuar me qëllime bamirësie;
3. ekspozitë ose takim kryesisht i organizuar për qëllime shkencore, teknike, artizanale, artistike, edukative ose kulturore, sportive, fetare dhe kulturi, sindikale, turistike ose, me qëllim nxitjen e marrëdhënieve të miqësisë mes vendeve të ndryshme;
4. takim i përfaqësuesve të organizatave ose shoqatave ndërkombëtare;
5. ceremoni dhe manifestime me karakter zyrtar ose përkujtimor, me përjashtim të ekspozitave të organizuara për qëllime private në dyqane ose ambiente të tjera tregtare me synim shitjen e mallrave të importit.

#### KREU II

#### Qëllimi

##### Neni 2

1. Lejimi i përkohshëm u jepet mallrave si më poshtë në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente:
  - a) mallrat që importohen me qëllim për t'u ekspozuar ose shfaqur në ndonjë aktivitet të veçantë, duke përfshirë materialet e referuara në shtojcat e Marrëveshjes mbi importin e materialeve edukative, shkencore dhe kulturore, UNESCO, Nju-Jork, 22 nëntor 1950 dhe protokollit të Nairobi, 26 nëntor 1976;
  - b) mallrat që synohet të përdoren për ekspozimin e mallrave të huaja në një eveniment, duke përfshirë:
    - i) mallrat e nevojshme për të demonstruar makineritë e importuara ose aparaturat që realizojnë paraqitjen;
    - ii) materiale ndërtimi dhe zbukurimi, përfshirë pajisje elektrike për stendat e përkohshme për ekspozuesit e huaj;
    - iii) materiale reklame dhe demonstrimi, siç është materiali reklamues për mallrat e huaja të ekspozuara, për shembull regjistrime zanore ose pamore, filma dhe diapozitiva, së bashku me aparaturat e nevojshme për përdorimin e tyre;
  - c) pajisje, duke përfshirë pajisje përkthimi, aparatura regjistrimi të zërit ose figurës, si dhe filma me karakter edukativ, shkencor dhe kulturor, me qëllim përdorimi në takime ndërkombëtare, konferenca dhe kongrese.
2. Për lehtësirat e referuara në këtë shtojcë, do të aplikohet:
  - a) numri ose sasia e secilit artikull të jetë e arsyeshme duke marrë parasysh qëllimin e importit;

b) organet doganore të territorit të lejimit të përkohshëm duhet të kënaqen me përmbushjen e kushteve të kësaj Konvente.

### KREU III

#### **Dispozita të ndryshme**

##### Neni 3

Përfunduar rasti kur legjislacioni vendas i territorit të lejimit të përkohshëm e lejon, mallrat që u jepet lejimi i përkohshëm, ndërkohë që janë objekt i lehtësirave të pranuar sipas kësaj Konventë, nuk duhet:

- a) të jepen hua ose të jepen me qira, ose të kompensohen; ose
- b) të zhvendosen nga vendi i ngjarjes.

##### Neni 4

1. Periudha e rieksporimit të mallrave të importuara për t'u shfaqur ose për t'u përdorur në ekspozita, panairë, takime ose ngjarje të njëjta duhet të jetë të paktën gjashtë muaj nga data e lejimit të përkohshëm.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, organet doganore do t'i lejojnë këto mallra që do të shfaqen ose përdoren në një ngjarje pasuese, madje dhe të qëndrojnë brenda territorit të lejimit të përkohshëm, duke iu përmbajtur kushteve të tilla që mund të kërkojnë ligjet dhe rregulloret e këtij territori dhe me kushtin që mallrat të rieksporthen brenda një viti nga data e lejimit të përkohshëm.

##### Neni 5

1. Në përputhje me termit e nenit 13 të kësaj Konvente, zhdoganimi i mallrave për përdorim vendas do të përjashtohet nga detyrimet dhe taksat e importit, si dhe do të përjashtohet nga ndalimet dhe kufizimet në lidhje me mallrat e mëposhtëm:

a) Mostra të vogla që përfaqësojnë mallra të huaja të shfaqur në një ngjarje, duke përfshirë mostra të tilla të ushqimeve dhe pijeve, ose të importuara në formën e këtyre mostrave ose të prodhuara nga materiale të importuara në atë ngjarje, me kushtin që:

i) ato të jenë furnizuar nga jashtë vendit falas dhe të përdoren vetëm për shpërndarjen falas për publikun që frekuenton atë ngjarje, për përdorim individual ose për konsum nga personat të cilëve u jepen;

ii) të jenë të identifikueshme si mostra me karakter reklame, me vlerë të ulët për çdo njësi;

iii) të mos jenë të përshtatshme për qëllime tregtare, dhe kur mundet, të vendosen në ambalazhe më të vogla mallrash sesa sasia më e vogël e të njëjtit mall, e shitur me pakicë;

iv) mostra të produkteve ushqimore dhe të pijeve jo të paketuara siç parashikohet në pikën (iii) më sipër, të konsumohen gjatë ngjarjes; dhe për nga vlera dhe sasia e tyre në tërësi, sipas mendimit të organeve doganore të territorit të lejimit të përkohshëm, të jenë në përputhje me natyrën e ekspozitës, numrin e vizitoreve dhe pjesëmarrësve në ekspozitë.

b) Mallrat e importuara vetëm për demonstrim ose për demonstrimin e një makine ose aparati të huaja të shfaqura në një ngjarje dhe që konsumohen ose asgjësohen gjatë demonstrimit, me kushtin që vlera dhe sasia e tyre tërësore, sipas mendimit të organeve doganore të territorit të lejimit të përkohshëm, të jenë në përputhje me natyrën e ekspozitës, numrin e vizitorëve dhe gamën e pjesëmarrjes së ekspozuesve në të.

c) Produkte me vlerë të vogël, që përdoren për ndërtimin, mobilimin dhe zbukurimin e stendave të përkohshme të pavijoneve të ekspozuesve të huaja gjatë një ngjarjeje si p.sh. bojëra, vernik, letër muresh, etj.

d) Materiale të shtypura, katalogë, njoftime tregtare, lista çmimesh, postera reklame, kalendarë të ilustruar ose jo, fotografi pa kornizë të cilat tregojnë se janë materiale reklamimi për mallrat e huaja të paraqitura në një ngjarje duke me kushtin që:

i) të jenë sjellë falas nga jashtë vendit dhe të përdoren vetëm për shpërndarje falas për publikun që viziton këtë ngjarje, dhe

ii) vlera dhe sasia e tyre tërësore, sipas mendimit të organeve doganore të territorit të lejimit të përkohshëm, të jetë në përputhje me natyrën e ekspozitës, numrin e vizitorëve dhe gamën e pjesëmarrjes së ekspozuesve në të.

e) Raporte, regjistra, formularë dhe dokumente të tjera të cilat importohen për t'u përdorur si të



tilla në, ose në lidhje me mbledhjet, konferencat ose kongreset ndërkombëtare.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk aplikohen për pijet alkoolike, produktet e duhanit dhe karburantet.

#### Neni 6

1. Kontrolli dhe zhdoganimi doganor për importin dhe rieksporimin e mallrave, të cilat do të paraqiten ose janë paraqitur ose përdorur gjatë një ngjarjeje, kur është e mundur, të bëhet në atë ngjarje.

2. Secila palë kontraktuese do të bëjë përpjekje, aty ku e konsideron të arsyeshme, duke pasur parasysh rëndësinë dhe përmasat e ngjarjes, të krijojë një zyrë doganore për një periudhë të arsyeshme në mjediset ku zhvillohet ngjarja brenda territorit të tij.

#### Neni 7

Produktet e përfituara aksidentalisht gjatë ngjarjes nga mallrat e lejimit të përkohshëm, si rrjedhojë e demonstrimit për makineritë ose aparatet e paraqitura, u nënshtrohen dispozitave të kësaj Konvente.

#### Neni 8

Secila palë kontraktuese ka të drejtën e rezervave, në përputhje me nenin 20 të kësaj Konvente, në përputhje me dispozitat e nenit 5, paragrafi 1 (a) i kësaj shtojce.

#### Neni 9

Pas hyrjes së saj në fuqi, kjo shtojcë, në përputhje me nenin 27 të kësaj Konvente, i jep fund dhe zëvendëson Konventën doganore lidhur me lehtësirat për importimin e mallrave gjatë paraqitjes ose përdorimit në ekspozita, panairë, mbledhje ose ngjarje të njëjta, Bruksel, 8 qershor 1961, në marrëdhënie midis palëve kontraktuese të cilët e kanë pranuar këtë shtojcë dhe janë palët kontraktuese të kësaj Konvente.

### SHTOJCA B. 2

#### SHTOJCA LIDHUR ME PAJISJET PROFESIONALE

#### KREU I

#### **Përkufizime**

##### Neni 1

Për qëllimet e kësaj shtojce, termi “pajisje profesionale” do të thotë:

1. pajisje për shtyp ose transmetim radiofonik apo televiziv, që i nevojiten përfaqësuesve të shtypit ose të transmetimeve radiofonike apo televizive që vizitojnë territorin e një vendi tjetër për qëllime reportazhi ose për të transmetuar apo regjistruar materiale për programe të caktuara. Një listë ilustruese e këtyre pajisjeve jepet në shtesën 1 të kësaj shtojce;

2. pajisje kinematografike që i nevojitet një personi që viziton një vend tjetër për të xhiruar një ose disa filma të caktuar. Një listë ilustruese për këto pajisje jepet në shtesën II të kësaj shtojce;

3. çdo pajisje tjetër e nevojshme për ushtrimin e vokacionit, tregtisë ose profesionit nga një person që viziton territorin e një vendi tjetër për të kryer një detyrë të caktuar. Nuk përfshin megjithatë, kjo kategori, pajisjet të cilat do të përdoren për prodhimin industrial ose paketimin e mallrave ose (me përjashtim të veglave të dorës) për shfrytëzimin e rezervave natyrore, për ndërtimin, riparimin ose mirëmbajtjen e ndërtesave, për gjerimin dhe zhvendosjen e dherave si dhe punë të tjera të ngjashme. Një listë ilustruese e këtyre pajisjeve jepet në shtesën III të kësaj shtojce;

4. aparatura ndihmëse për pajisjet e përmendura në pikën 1, 2 dhe 3 të këtij neni dhe aksesorëve përkatës.

#### KREU II

## **Qëllimi**

### Neni 2

Lejimi i përkohshëm jepet për mallrat si më poshtë në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente:

- a) pajisjet profesionale;
- b) pjesët përbërëse të importuar për riparimin e pajisjeve profesionale të lejuara përkohësisht sipas paragrafit (a) më sipër.

## **KREU III**

### **Dispozita të ndryshme**

#### Neni 3

1. Për lehtësirat e parashikuara nga kjo shtojcë për t'u zbatuar, pajisjet profesionale:

- a) duhet t'i përkasin një personi të vendosur ose rezident jashtë territorit të lejimit të përkohshëm;
- b) duhet të importohen nga një person i vendosur ose rezident jashtë territorit të lejimit të përkohshëm;
- c) duhet të përdoren vetëm ose nën mbikëqyrjen personale të personit që viziton këtë territor të lejimit të përkohshëm.

1. Paragrafi 1 nuk zbatohet për pajisjet kinematografike që importohen për prodhim filmash, programesh televizive ose vepra audiovizive, sipas një kontrate bashkëprodhimi të kryer me një person të vendosur në territorin e lejimit të përkohshëm i cili është palë dhe që është miratuar nga organet kompetente të atij territori sipas një marrëveshjeje ndërqeveritare lidhur me bashkëprodhimin.

2. Pajisjet kinematografike dhe pajisjet për shtyp ose transmetim radiofonik apo televiziv, nuk janë objekt i kontratave të qiradhënies ose marrëveshjeje të njëjta në të cilat një person i vendosur në territorin e lejimit të përkohshëm është palë, me kusht që kjo të mos aplikohet në rastin e programeve të përbashkëta për transmetim radiofonik apo televiziv.

#### Neni 4

1. Lejimi i përkohshëm i pajisjeve për prodhimin dhe transmetimin radiofonik dhe televiziv dhe veçanërisht përvetësimi i furgonave radiofonikë ose televizivë dhe pajisjeve të tyre, të importuara nga organe publike ose private të miratuara për atë qëllim nga organet doganore të territorit të lejimit të përkohshëm, jepet pa kërkuar ndonjë dokument ose garancie doganore.

2. Organet doganore mund të kërkojnë paraqitjen e një liste ose inventari të detajuar të pajisjeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij nen, së bashku me angazhimin me shkrim për të rieksportuar.

#### Neni 5

Periudha për rieksportimin e pajisjeve profesionale duhet të jetë të paktën dymbëdhjetë muaj nga data e lejimit të përkohshëm. Periudha për rieksportimin e automjeteve, gjithsesi, mund të përcaktohen në lidhje me qëllimin dhe kohëzgjatjen e qëllimshme të qëndrimit në territorin e lejimit të përkohshëm.

#### Neni 6

Secila palë kontraktuese ka të drejtën për të refuzuar ose anuluar lejimin e përkohshëm në lidhje me automjetet e përmendura në shtesat I dhe III të kësaj shtojce, që dhe rastësisht, ngarkojnë personat për pagesën ose ngarkimin e mallrave në territorin e saj, për shkarkimin dhe zbarkimin në një vend brenda territorit të njëjtë.

#### Neni 7

Shtesat e kësaj shtojce do të konceptohen si pjesë integrale saj.

## Neni 8

Hyrja në fuqi e kësaj shtojce, në përputhje me nenin 27 të kësaj Konvente, sjell shfuqizimin dhe zëvendësimin e Konventës doganore mbi importimin e përkohshëm të pajisjeve profesionale, Bruksel, 8 qershor 1961, në marrëdhënie midis palëve kontraktuese të cilët kanë miratuar këtë shtojcë dhe janë palët kontraktuese të kësaj Konvente.

### SHTOJCA I

#### Listë ilustruese

Pajisje për shtypin ose për mjetet televizive ose dëgjuese

A) Pajisje për shtypin si:

- kompjuterë;
- pajisje telefaksi;
- makina shkrimi;
- kamera të të gjitha llojeve (kamera filmi dhe elektronike);
- aparate për transmetimin, incizimin ose riprodhimin e zërit ose të imazhit (magnetofonë dhe videoregjistruar, dhe videoriprodhues, mikrofonë, konsolle për përzierje, bokse zëri);
- media për regjistrimin e imazhit ose të tingujve, të regjistruara ose të paregjistruara;
- instrumente për matje dhe testim dhe aparate (oshilografe, sisteme testimi për magnetofon dhe regjistruar video, multimetër, kuti mjetesh dhe çanta, vektoskope, riprodhues video etj.);
- pajisje ndriçuese (projektorë, konvertues, mbajtëse trikëmbëshe);
- aksesorë operativë (kaseta, ekspozimetra, lente, mbajtëse trikëmbëshe, akumulatorë, rripa baterie, karikues baterish, monitorë).

b) Pajisje televizive për zërin, si:

- pajisje telekomunikacioni, si transmetues ose marrës televizivë; terminale që mund të lidhen me rrjetë ose satelit; lidhje satelitore;
- pajisje për prodhimin me frekuencë të tingullit (ngritës zëri, aparate për regjistrim ose riprodhim);
- instrumente për matje dhe testim dhe aparate (oscilografë, sisteme testimi për magnetofon dhe regjistruar video, multimetër, kuti mjetesh dhe çanta, vektoskope, riprodhues video, etj.);
- aksesorë operacionalë (ora, kronometra, kompasë, mikrofonë, konsolle për përzierje, kaseta, komplete riprodhimi, transformatorë, bateri dhe akumulatorë, karikues baterish, ngrohës, aparate për ajrin e kondicionuar dhe ventilimin, etj.);
- media për regjistrimin e zërit, të regjistruara ose të paregjistruara.

c) Pajisje televizive për televizionin, si:

- kamera televizive;
- telekinema;
- aparate dhe instrumente për testim dhe matje;
- aparate për transmetim dhe ritransmetim;
- aparate komunikimi;
- aparate për regjistrimin ose riprodhimin e imazhit dhe të tingullit (regjistruar kasetash magnetofoni dhe video dhe video riprodhues, mikrofonë, konsolle për përzierje, bokse zëri);
- pajisje ndriçuese (prozektorë, konvertues, mbajtëse trekëmbësh);
- pajisje për botim;
- aksesorë operacionalë (ora, kronometra, kompasë, lente, ekspozimetra, mbajtës trekëmbësh, karikues baterish, kaseta magnetofoni, komplete riprodhues, transformatorë, bateri dhe akumulatorë, ngrohës, aparate për ajrin e kondicionuar dhe ventilimin, etj.);
- media për regjistrimin e imazhit ose të zërit, të regjistruara ose të paregjistruara (tituj krediti, stacione me shenjë identifikuese, vënës muzike, etj.);
- "plane të pamontuara filmash";
- instrumente muzikore, kostume, skenografi dhe materiale të tjera skenike, piedestale, materiale për makijazh, tharëse flokësh.

d) Mjete të dizenuara ose veçanërisht të adaptuara për qëllimet specifike të mësipërme, si për shembull mjetet e transmetimit televiziv, mjetet për aksesorët televizivë, mjetet për regjistrimin ose riprodhimin e imazhit ose të zërit, mjete me lëvizje të ngadaltë, mjete ndriçuese.

## SHTOJCA II MATERIALE KINEMATOGRAFIKE

### Listë ilustruese

- a) Pajisje, si:
- kamera të të gjitha llojeve (kamera filmike dhe elektronike);
  - instrumente dhe aparate për testim dhe matje (oshilografë, sisteme testimi për regjistruar kasetash magnetofoni dhe video, multimetra, kuti mjeteve dhe çanta, vektorskope, riprodhues video, etj.);
  - karela kamerash dhe krahë mikrofon;
  - pajisje ndriçuese (projektorë, konvertues, mbajtëse trekëmbësh);
  - pajisje botuese;
  - aparate për regjistrimin e riprodhimin e imazhit dhe të tingullit (regjistruar magnetofoni dhe video dhe videoriprodhues, mikrofon, konsolle për përzjerjen, bokse zëri);
  - media për regjistrimin e imazhit dhe të zërit, të regjistruara ose të paregjistruara (tituj krediti, stacion me shenjë identifikuese, vënës muzike, etj.);
  - "plane të pamontuara filmash";
  - aksesorë operacionalë (ora, kronometra, kompase, mikrofon, konsolle për përzjerje, kasete magnetofoni, komplete riprodhues, transformator, bateri dhe akumulatorë, karikues baterish, ngrohës, aparate për ajrin e kondicionuar dhe ventilimin, etj.);
  - instrumente muzikore, kostume, skenografi dhe materiale të tjera skenike, piedestale, materiale për makijazh, tharëse flokësh.
- b) Automjete të përcaktuara ose të përshtatura posaçërisht për qëllimet e specifikuar më sipër.

## SHTOJCA III C. PAJISJE TË TJERA

- A) Pajisje për ngritje, testim, vënie në punë, kontroll, mirëmbajtje ose riparim të makinerive, impiantit, mjeteve të transportit, etj., si:
- mjete;
  - pajisje dhe instrumente për matje, kontroll ose testim (temperature, presioni, distance, peshe, sipërfaqe, shpejtësi, etj.), duke përfshirë instrumente elektrike (voltmetra, ampermetra, kablllo matëse, komparatorë, transformatorë, instrumente regjistruar, etj.), dhe mbajtës instrumentesh;
  - aparate dhe instrumente për fotografimin e makinerive ose impianteve gjatë dhe pas ngritjes,
  - aparate për mbikëqyrjen e anijeve.
- B) Pajisje të nevojshme për biznesmenë, për efikasitetin e konsulentëve të biznesit, ekspertë të produktivitetit, financiarë dhe pjesëtarë të profesioneve të ngjashme, si:
- kompjuterë;
  - makina shkrimi;
  - transmetues imazhi dhe zëri, aparate regjistrimi ose riprodhimi;
  - aparate dhe instrumente llogaritës.
- C) Pajisje të nevojshme për ekspertë që ndërmarrin sondazhe topografike ose pune kërkuese gjeofizike, si:
- aparate dhe instrumente matës;
  - pajisje shpuese;
  - pajisje transmetimi dhe komunikimi.
- D) Pajisje të nevojshme për ekspertë që luftojnë kundër ndotjes së mjedisit.
- E) Instrumente dhe aparate të nevojshme për doktorë, kirurgë, kirurgë veterinarë, mami dhe pjesëtarë të profesioneve të ngjashme.
- F) Pajisje të nevojshme për arkeologë, paleontologë, gjeografë, zoologë ose shkencëtarë të tjerë.
- G) Pajisje të nevojshme për argëtues, për shoqëri teatrore dhe orkestra, duke përfshirë të gjithë artikujt e përdorur për shfaqje publike ose private (instrumente muzikore, kostume, skenografi, etj.).
- H) Pajisje të nevojshme për leksione ose për ilustrimin e këtyre leksioneve.
- I) Pajisje të nevojshme për udhëtime fotografike (kamera të të gjitha llojeve, kasete, ekspozimetra, lente, mbajtëse trekëmbësh, akumulatorë, rripa baterie, karikues baterish, monitorë, pajisje ndriçuese, mallra mode dhe aksesore për foto modele, etj.).

J) Automjete të përcaktuara ose të përshtatura posaçërisht për qëllimin e sipërpërmendur, si: njësi inspektimi të lëvizshme, punishte lëvizëse dhe laboratorë lëvizës.

**SHTOJCA B.3**  
**SHTOJCË PËR KONTENIERËT PALETET, AMBALAZHET MOSTRAT DHE MALLRA TË TJERA**  
**TË IMPORTUARA NË LIDHJE ME NJË OPERACION TREGTAR**

**KREU I**  
**Përkufizime**  
Neni 1

Për qëllime të kësaj shtojce, me termin:

a) "mallra të importuara në lidhje me një operacion tregtar" kuptohen:

kontejnerët, paletat, ambalazhet, mostrat, filmat publicitarë dhe mallra të tjera të importuara në lidhje me një operacion tregtar, importimi i të cilave nuk përbën në vetvete një operacion tregtar;

b) me "ambalazh" kuptohen:

të gjithë artikujt dhe materialet e përdorur ose për t'u përdorur, në gjendjen që janë importuar, për të ambalazhuar, mbrojtur, vendosur ose ndarë mallrat, duke përfshirë materiale të tilla si: kashtë, letër, lesh xhami, tallash, kur importohen në ngarkesa të mëdha. Kontejnerët dhe paletat, siç përcaktohen në pikat (c) dhe (d) të këtij neni janë gjithashtu përfshirë përkatësisht;

C) me "kontejner" kuptohet:

një pajisje transporti (kamion me ngritje, cisternë e lëvizshme ose struktura të tjera të ngjashme):

i) përbën një ndarje të mbyllur, plotësisht ose pjesërisht, për të mbajtur mallra;

ii) pajisje e pandryshueshme dhe e fortë mjaftueshëm për të pasur përdorim të përsëritur;

iii) e ndërtuar në mënyrë të tillë për të lehtësuar transportin e mallrave nëpërmjet një ose disa mënyrave të transportit, pa qenë nevoja e ngarkimit dhe e shkarkimit të ndërmjetëm;

iv) ndërtuar për manovrim të menjëhershëm, sidomos kur kalohet nga një mënyrë transporti në një mënyrë tjetër transporti;

iv) ndërtuar për t'u ngarkuar dhe shkarkuar lehtësisht; dhe

vi) kanë një volum të brendshëm prej një metri kub ose më shumë.

Në "kontejner (mbajtës)" përfshihen dhe aksesorët dhe pajisjet e kontejnerit, të përshtatshme për llojin në fjalë, me kusht që aksesorë dhe pajisje të tilla të transportohen së bashku me kontejnerin. Termi "kontejner" nuk do të përfshijë automjetet, aksesorët, ose pjesët e këmbimit të tyre, ose ambalazhet dhe paletat. "pjesë të çmontueshme" do të konsiderohen si kontejnerë;

d) me "palët" kuptohet:

një pajisje në sipërfaqe të së cilës mund të vendosen së bashku një sasi mallrash duke formuar një njësi ngarkese për qëllime transporti, lëvizje ose ruajtje apo stivim të mallit nëpërmjet ndihmës së pajisjeve mekanike. Kjo pajisje përbëhet prej dy kate të lidhura ndërmjet tyre prej traversash ose nga një kat i vetëm i mbështetur mbi këmbë; lartësia e përgjithshme duhet të jetë aq sa të bëjë të mundur lëvizjen me vinça pirun ose karelat e paletave, dhe mund të kenë ose jo edhe superstrukturë të ngritur mbi to;

e) me "mostra" kuptohen:

artikuj që përfaqësojnë një kategori të caktuar mallrash, të prodhuara ose që janë shembuj mallrash, të cilat duhet të prodhohen, përfshirë artikuj identikë të sjellë nga i njëjti individ, ose dërguar një marrësi të vetëm, në masën që e marrë në tërësi, sipas përdorimit të zakonshëm tregtar nuk përbejnë më artikuj mostre;

f) me "filma publicitarë" kuptohen:

pajisje të regjistrimit vizual, me ose pa efekte zanore, që konsiston kryesisht në imazhe që paraqesin karakterin ose mënyrën e përdorimit të produkteve ose pajisjeve të vendosura për shitje ose me qira nga një person me seli ose vendbanim jashtë territorit të përjashtimit të përkohshëm, me kusht që filmat janë të një lloji të përshtatshëm për demonstrim të klientët potencialë, por jo për demonstrim të përgjithshëm për publikun, dhe të jenë importuar në një ambalazhim që nuk ka më shumë se një kopje të secilit film dhe që nuk përbën pjesë të një dërgese më të madhe me filma;

g) me "trafik të brendshëm" do të kuptohet:

transporti i mallrave të ngarkuara në territorin doganor të një pale kontraktuese për t'u shkarkuar në një vend brenda territorit doganor të së njëjtës palë kontraktuese.

## KREU II

### Qëllimi

#### Neni 2

Mallrave të më poshtme që kanë lidhje me një operacion tregtar do t'u jepet lejimi i përkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente:

a) ambalazhe të importuara të mbushura për t'u rieksportuar të mbushura ose të zbrazura ose të importuara të zbrazura për t'u rieksportuar të mbushura;

b) kontejnerë, nëse janë ose jo të mbushur me mallra, dhe aksesore dhe pajisje të mbajtësve të lejuar përkohësisht, të cilat janë importuar me një mbajtës për t'u rieksportuar veçmas ose me një mbajtës tjetër, ose janë importuar veçmas për t'u rieksportuar me një mbajtës;

c) pjesë përbërëse të destinuara për riparimin e mbajtësve që i është dhënë lejimi i përkohshëm sipas pikës (b) të këtij neni;

d) paleta;

e) mostra;

f) filma publicitarë;

g) çdo lloj tjetër malli importuar për këdo nga qëllimet e renditura në shtojcën I të kësaj shtojca në lidhje me operacionet tregtare por importimi i të cilave nuk përbën në vetvete një operacion tregtar.

## KREU III

### Dispozita të ndryshme

#### Neni 3

Dispozitat e kësaj shtojce nuk ndikojnë legjislacionin doganor të palëve kontraktuese në lidhje me importimin e mallrave të transportuara në mbajtës ose ambalazhe ose në paleta.

#### Neni 4

1. Për qëllimin e përfitimit të lehtësirave të dhëna nga ky shtojcë:

a) ambalazhet mund të rieksportohen vetëm nga personi përfitues të lejimit të përkohshëm. Ato nuk do të përdoren, qoftë dhe rastësisht në trafikun e brendshëm;

b) mbajtësit (kontejnerët) duhet të shenjëzohen sipas mënyrës së përshkruar në shtojcën II të kësaj shtojce. Ato mund të përdoren për trafikun e brendshëm, por në këtë rast, çdo pale kontraktuese i nënshtrohet përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

- udhëtimi duhet të sjellë kontejnerin përgjatë një itinerari të arsyeshëm ose sa më afër me vendin ku ngarkesa e eksportit do të ngarkohet ose nga ku kontejneri do të eksportohet bosh;

- kontejneri do të përdoret vetëm një herë në trafikun e brendshëm përpara se të rieksportohet;

c) paletat ose një numër i barabartë paletash i të njëjtit lloj dhe kryesisht me të njëjtën vlerë duhet të kenë qenë më parë të eksportuara ose që do të eksportohen më pas ose rieksportohen;

d) mostrat dhe filmat publicitarë duhet të jenë në pronësi të një personi që është rezident jashtë territorit të lejimit të përkohshëm dhe duhet të importohet vetëm për qëllime për t'u treguar ose demonstruar në territorin e lejimit të përkohshëm për të tërhequr porosi për import të këtyre mallrave në atë territor. Ato nuk mund të shiten ose të vendosen për përdorim normal përveç qëllimit të demonstrimit, ose përdorur në çfarëdo mënyre për dhënie me qira ose shpërbllim ndërkohë që është në territorin e lejimit të përkohshëm;

e) mallrat referuar në pikat 1 dhe 2 të shtojcës I të kësaj shtojce nuk do të përdoren për aktivitet fitimprurës.

2. Çdo palë kontraktuese do të kenë të drejtën të refuzojnë lejimin e përkohshëm për kontejnerët, paletat ose ambalazhet që kanë qenë objekt i blerjes, qira-blerjes, dhënies me qira ose një kontrate të një natyre të tillë, kryer nga një person i vendosur ose rezident në territorin e palës kontraktuese në fjalë.

#### Neni 5

1. Lejimi i përkohshëm për kontejnerët, paletat ose ambalazhet do të jepet pa dokument doganor

ose pa kërkuar garanci.

2. Në vend të një dokumenti doganor dhe garancisë për kontejnerët, personit të cilit i është akorduar lejimi i përkohshëm, mund t'i kërkohet me shkrim:

i) të vërë në dispozicion të autoriteteve doganore, në bazë të kërkesës së tyre, informacion të detajuar mbi lëvizjet e çdo kontejneri që i është dhënë lejimi i përkohshëm, përfshirë datat dhe vendet e hyrjes dhe daljes nga territori i lejimit të përkohshëm, ose një listë të kontejnerëve bashkë me zotimin për t'i rieksportuar,

ii) të paguajë detyrimet e importit dhe taksat sipas nevojës, në rastet kur kushtet e lejimit të përkohshëm nuk janë përmbushur.

2. Në vend të një dokumenti doganor dhe garancisë për paletat dhe ambalazhet, personit të cilit i është dhënë autorizimi i lejimit të përkohshëm, mund t'i kërkohet t'u paraqesë autoriteteve doganore një deklaratë me shkrim ku zotohet për rieksportim.

3. Personat të cilët përdorin rregullisht procedurën e lejimit të përkohshëm do të autorizohen që të paraqesin një deklaratë të përgjithshme ku zotohen.

#### Neni 6

Periudha për rieksportimin e mallrave në lidhje me një operacion tregtar do të jetë të paktën gjashtë muaj nga data e lejimit të përkohshëm.

#### Neni 7

Çdo palë kontraktuese ka të drejtën të paraqesë rezerva në përputhje me nenin 29 të kësaj Konvente, në lidhje me:

- a) jo më shumë se tre grupe mallrash të renditura në nenin 2;
- b) nenin 5, paragrafi 1 i kësaj shtojce.

#### Neni 8

Shtesat e kësaj shtojce janë pjesë integrale e kësaj të fundit.

#### Neni 9

Me hyrjen në fuqi, kjo shtojcë, në përputhje me nenin 27 të kësaj Konvente, do të shfuqizojë dhe zëvendësojë dispozitat dhe konventat e mëposhtme:

- Konventa europiane mbi trajtimin doganor të paletave të përdorura për transport ndërkombëtar, Gjenevë, 9 dhjetor 1960;
- Konventa doganore mbi importimin e përkohshëm të ambalazheve, Bruksel, 6 tetor 1960;
- nenet 2-11 dhe shtojcat 1 (paragraf 1 dhe 2) -3 të Konventës doganore për kontejnerët, Gjeneva, 2 dhjetor 1972;
- nenet 3, 5 dhe 6 (1.b dhe 2) të Konventës ndërkombëtare për lehtësimin e importit të mostrave tregtare dhe materialeve publicitare, Gjenevë, 7 nëntor 1952 në marrëdhëniet midis palëve kontraktuese të cilat kanë pranuar këtë shtojcë dhe janë palë kontraktuese në këto konventa.

### SHTOJCA I

#### LISTA E MALLRAVE SIPAS NENIT 2 (G)

1. Mallra të importuara për testim, kontroll, eksperimentime ose demonstrime.
2. Mallra për përdorim në testim, kontroll, eksperimentime ose demonstrime.
3. Filma kinematografikë të zhvilluar ose printuar, pozitivë dhe media të tjera që kanë të regjistruar imazhe me qëllim për t'u parë para përdorimit të tyre tregtar.
4. Filma, kaseta magnetike, filma të magnetizuar dhe media të tjera që mbajnë tingull ose imazh të destinuara për dublim, regjistrim ose riprodhim të tingullit.
5. Elemente të medias me të dhëna, të dërguara falas për përpunim automatik të dhënash.
6. Artikuj (përfshirë automjetet) të cilat, në bazë të natyrës së tyre, janë të papërshtatshme për ndonjë qëllim tjetër, përveç se publicitetit të artikujve specifikë ose publicitetit për një qëllim specifik.

## SHTOJCA II DISPOZITA RRETH SHENJËZIMIT TË KONTEJNERËVE (MBAJTËSVE)

1. Informacioni i mëposhtëm do të shenjëzohet në mënyrë permanente dhe në vend qartësisht të dukshëm mbi kontejnerë (mbajtës):

- a) identifikimi i pronarit ose përdoruesit kryesor;
- b) shenjat identifikuese dhe numrat e kontejnerit, të dhëna nga pronari ose përdoruesi, dhe
- c) pesha e mbajtësit, përfshirë dhe pajisjet e tij të vendosura në mënyrë permanente.

2. Shteti të cilit i përket kontejneri mund të tregohet ose i plotë, ose nëpërmjet kodit të shtetit ISO Alpha-2 që jepen sipas standardeve ndërkombëtare ISO 3166, ose nëpërmjet shenjave dalluese që përdoren për të treguar shtetin e regjistrimit të automjeteve në trafikun rrugor ndërkombëtar. Çdo shtet mund të përcaktojë përdorimin e emrit ose të shenjës dalluese në kontejner sipas legjislacionit kombëtar përkatës. Identiteti i pronarit ose përdoruesit mund të tregohet ose nëpërmjet emërimit të plotë, ose nëpërmjet një identifikimi të përcaktuar, ku simbolet si emblemat ose flamujt janë të përjashtuar.

3. Për shenjat dhe numrat identifikues që vendosen mbi mbajtës që konsiderohen të shenjëzuar në mënyrë permanente kur përdoret ambalazh prej flete plastike, nevojiten të përmbushen specifikimet e mëposhtme:

a) një material adeziv i cilësisë së lartë duhet të përdoret. Shiriti plastik pasi të jetë vendosur, duhet të ketë një forcë mbajtëse më të ulët se ngjitja adezive përfundimtare në mënyrë që heqja e shiritit pa e shkatërruar atë të jetë e pamundur. Shiriti i prodhuar me metodë kast përmbush këto kërkesa. Shiritat e prodhuar me kalandaturë nuk do të përdoren;

b) kur shenjat e identifikimit dhe numrat duhet të ndryshohet, shiriti që duhet zëvendësuar duhet të hiqet plotësisht para vendosjes së shiritit të ri, vendosja e një shiriti të ri mbi shiritin ekzistues nuk do të lejohet.

1. Specifikimet për përdorimin e shiritit plastik për shenjëzimin e mbajtësve përcaktuar nga paragrafi 3 i kësaj shtojce nuk përjashton mundësinë e përdorimit të metodave të tjera të shenjëzimit në mënyrë permanente.

### SHTOJCA B.4

#### SHTOJCË PËR MALLRAT E IMPORTUARA NE LIDHJE ME NJË OPERACION PËRPUNIMI

##### KREU I

##### **Përkufizime**

###### Neni 1

Për qëllime të kësaj shtojce me termin “mallra të importuara në lidhje me një operacion përpunimi” do të kuptohet:

1. a) matrica, blloqe, pllaka, stampa, dizeno, plane, modele dhe artikuj të tjerë të ngjashëm;
- b) instrumente matëse, kontrolluese, verifikuese dhe artikuj të tjerë të ngjashëm;
- c) instrumente dhe vegla të veçanta të importuara gjatë një procesi përpunimi; dhe
2. "pjesë zëvendësuese të mjeteve përpunuese ":

instrumente, aparate dhe makineri që vihen në dispozicion të klientit nga furnizuesi ose riparuesi, në pritje të dërgimit ose riparimit të produkteve të tilla.

##### KREU II

##### **Qëllimi**

###### Neni 2

Mallrave të importuara në lidhje me një operacion përpunimi do t'u jepet lejimi i përkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente.

##### KREU III

##### **Dispozita të ndryshme**

###### Neni 3



Për të përfituar lehtësitë nga kjo shtojcë, duhet që:

a) mallrat e importuara në kuadrin e një operacioni përpunues duhet të jenë në pronësi të një personi i vendosur jashtë territorit të lejitimit të përkohshëm dhe të destinuara për një person të vendosur në një territor të tillë;

b) gjithë prodhimi ose pjesë e tij, në bazë të legjislacionit kombëtar, që rezulton nga përdorimi i mallrave të importuara në kuadrin e një procesi përpunimi, sipas nenit 1, paragrafit 1, të kësaj shtojce, duhet të eksportohet nga territori i lejitimit të përkohshëm;

c) pjesë zëvendësuese të mjeteve përpunuese duhet të jenë të disponueshme, përkohësisht dhe pa pagesë, për personin e vendosur në territorin e lejitimit të përkohshëm nga ose nëpërmjet furnizuesit të mjetit të përpunimit dërgesa e të cilit është shtyrë ose që duhet të riparohet.

#### Neni 4

1. Periudha për rieksporimin e mallrave të përfshira në nenin 1, paragrafi 1 të kësaj shtojce duhet të jetë të paktën 12 muaj nga data e lejitimit të përkohshëm.

2. Periudha e rieksporimit të pjesës zëvendësuese të mjetit të përpunimit duhet të jetë të paktën gjashtë muaj nga data e lejitimit të përkohshëm.

### SHTOJCA B. 5

## SHTOJCA PËR MALLRAT E IMPORTUARA PËR QËLLIME EDUKATIVE, SHKENCORE OSE KULTURORE

### KREU I

#### **Përcaktime**

#### Neni 1

Për qëllime të kësaj shtojce:

a) me termin "mallra të importuara për qëllime edukative, shkencore ose kulturore " do të kuptohen:

pajisje shkencore, materiale pedagogjike, materiale ndihmëse për lundëtarët dhe çdo material tjetër i lidhur me aktivitetet edukative, shkencore dhe kulturore;

b) në paragrafin (a) sipër:

i) me termin "pajisje shkencore dhe materiale pedagogjike do të kuptohet:

çdo model, instrument, aparat, makineri ose pjesët e tyre të përdorura për qëllime të kërkimeve shkencore ose trajnim edukativ ose profesional;

ii) me termin "material ndihmues për lundëtarët " do të kuptohet:

material për ndjekjen e aktiviteteve kulturore, edukative, rikrijuese, fetare ose sportive nga persona të ngarkuar me detyra në lidhje me punën ose shërbimin në det në mjet lundrues të huaj të angazhuar në transportin detar ndërkombëtar.

Listat ilustruese për "materialet pedagogjike", "material ndihmues për lundëtarët " dhe "çdo mall tjetër importuar në lidhje me aktivitetet edukative, shkencore ose kulturore " janë riprodhuar përkatësisht në shtojcat I, II dhe III, të kësaj shtojce.

### KREU II

#### **Qëllimi**

#### Neni 2

Mallrave të mëposhtme do t'u jepet lejim i përkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente:

a) mallrat e importuara ekskluzivisht për qëllime edukative, shkencore ose kulturore;

b) pjesët e këmbimit, pajisje shkencore dhe materiale pedagogjike që i është dhënë lejim i përkohshëm sipas paragrafit (a) më sipër, dhe veglat të dizenuara në mënyrë specifike për mirëmbajtjen, kontrollin, matje ose riparimin e pajisjeve të tilla.

### KREU III

#### **Dispozita të ndryshme**

##### Neni 3

Për të përfituar lehtësitë që jepen prej kësaj shtojce duhet që:

a) mallrat e importuara për qëllime shkencore, edukative dhe kulturore të jenë në pronësi të një personi të vendosur jashtë territorit të lejimit të përkohshëm dhe duhet të importohen nga institucionet për të cilat është dhënë miratimi në sasi të arsyeshëm, duka mbajtur në konsideratë qëllimin e importimit;

b) materiali ndihmues për lundëtarët duhet të përdoret në bordin e anijeve të huaja të angazhuara në transportin detar ndërkombëtar ose duhet të shkarkohen nga anija për t'u përdorur përkohësisht në tokë nga ekuipazhi, ose duhet të importohet për përdorim në fjetore, klube ose qendra argëtimi për lundëtarët, të menaxhuara ose nga organizata zyrtare ose fetare ose organizata jofitimprurëse dhe vende adhurimi fetar ku mbahen shërbime të rregullta për lundëtarët.

##### Neni 4

Lejimi i përkohshëm për pajisje shkencore dhe materiale pedagogjike dhe materiale ndihmëse për lundëtarët të përdorura në bordin e anijeve do të jepet pa qenë nevoja e një dokumenti doganor ose garancie. Kur është e nevojshme mund të kërkohet një inventar së bashku me një deklaratë me shkrim për të bërë riekspertin për pajisjet shkencore dhe materialet pedagogjike.

##### Neni 5

Periudha e riekspertimit për mallrat e importuara për qëllime edukative, shkencore ose kulturore do të jetë të paktën 12 muaj nga data e lejimit të përkohshëm.

##### Neni 6

Çdo palë kontraktuese ka të drejtën të paraqesë rezerva në përputhje me nenin 29 të kësaj Konvente, për sa i përket dispozitave të nenit 4 të kësaj shtojce, në lidhje me pajisjet shkencore dhe materiale pedagogjike.

##### Neni 7

Shtesat e kësaj shtojce do të konsiderohen si pjesë integrale të tij.

##### Neni 8

Me hyrjen në fuqi, kjo shtojcë, në përputhje me nenin 27 të kësaj Konvente, do të shfuqizojë dhe zëvendësojë konventën doganore mbi materialin ndihmës për lundëtarët, Bruksel, 1 dhjetor 1964, Konventën doganore për importimin e përkohshëm të pajisjeve shkencore, Bruksel, 11 qershor 1968, dhe Konventën doganore mbi importimin e përkohshëm të materialeve pedagogjike, Bruksel, 8 qershor 1970, për sa i përket palëve kontraktuese, të cilat kanë pranuar këtë shtojcë dhe janë palë kontraktuese me këtë Konventë.

#### SHTOJCA I MATERIAL PEDAGOGJIK LISTË ILUSTRUESE

a) Regjistruarit ose riprodhuesit e tingullit ose imazhit si:

- projektorë me diapozitiv dhe shirit;
- projektorë kinematografikë;
- retroprojektorë dhe episkopë;
- magnetofon, magnetoskopë dhe pajisje video;
- pajisje televizive me qark të mbyllur.

b) Media tingulli ose imazhi si:

- diapozitiv, shirit filmik dhe mikrofilma;

- filma kinematografikë;
- incizime tingulli (kaseta magnetike, disqe);
- videokaseta.

c) Materiale të veçanta si:

- pajisje bibliografike dhe materiale audiovizive për libraritë;
- librari të lëvizshme;
- laboratorë gjuhësorë;
- pajisje të përkthimit simultan;
- pajisje për mësim të programuara, mekanike ose elektronike;
- material i projektuar posaçërisht për trajnim arsimor ose profesional të personave me aftësi të kufizuara.

d) Materiale të tjera si:

-tabela mësimore, modele, grafikë, harta, planimetri, foto dhe vizatime; instrumente, aparate dhe modele të projektuara për qëllime demonstruese; mjete për studim me informacion pedagogjik vizual ose zanor përgatitur për mësimin e një lënde (mjete studimore); instrumente, aparate, vegla dhe vegla-makinë për të mësuar një shërbim ose zanat; pajisje, përfshirë ato që janë adoptuar posaçërisht për operacionet e shpëtimit, që importohen për trajnimin e personave të angazhuar në operacionet e shpëtimit.

## SHTOJCA II MATERIAL NDIHMËS PËR LUNDËRTARËT LISTA ILUSTRUESE

A. Materiale leximi, të tilla si:

- libra të çdo lloji;
- kurse korrespondence;
- gazeta, revista dhe botime periodike;
- broshura ndihmese ne port.

B. Materiale audiovizive, të tilla si:

- instrument riprodhues zanor dhe të imazheve;
- kaseta regjistruese;
- aparate radio dhe televizion;
- projektorë kinematografikë dhe të tjerë;
- regjistrim ne kaseta ose disqe (kurse gjuhe, radio programe, përshëndetje, muzike dhe argëtim);
- film i ekspozuar dhe i zhvilluar;
- diapozitiv filmik;
- video kaseta.

C. Pajisje sportive, të tilla si:

- veshje sportive,
- topa,
- raketa dhe rrjeta,
- sporte lundrimi,
- pajisje atletike,
- pajisje gjimnastike.

D. Materiale për hobi, të tilla si:

- lojëra ne salla të mbyllura;
- instrumente muzikore;
- materiale për teatrin amator;
- materiale për pikturim, skulpture, punime druri dhe metalike, prodhim qilimi, etj.

E. Pajisje për veprimtari fetare

F. Pjesë dhe aksesore për materialet ndihmëse.

## SHTOJCA III

## MALLRA TË TJERA TË IMPORTUARA NË LIDHJE ME AKTIVITETET EDUKATIVE, SHKENCORE OSE KULTURORE LISTA ILUSTRUESE

Mallra të tilla si:

1. kostume dhe mjete të skenës të dhëna hua pa pagesë për shoqëri teatrale ose teatro;
2. partitura muzikore të dhëna hua pa pagesë për teatro muzikore ose orkestra.

#### SHTOJCA B.6

### SHTOJCË PËR SENDET PERSONALE TË UDHËTARIT DHE MALLRAT E IMPORTUARA PËR QËLLIME SPORTIVE

#### KREU I

##### **Përcaktime**

##### Neni 1

Për qëllime të kësaj shtojce, me termin:

a) "udhëtar" kuptohet:

çdo person që hyn përkohësisht në territorin e një pale kontraktuese në të cilin ai ose ajo nuk banon normalisht aty, për qëllime turistike, sportive, biznesi, profesionale, takime, shëndetësore, studimore, etj.;

b) me "sende personale" do të kuptohet :

të gjithë artikujt, të rinj ose përdorur të cilat një udhëtuesi i nevojiten në mënyrë të arsyeshme për përdorimin e tij ose të saj personal gjatë udhëtimit, duke marrë parasysh të gjithë rrethanat e udhëtimit, por duke përjashtuar çdo mall të importuar për qëllime tregtare. Një listë ilustruese e sendeve personale jepet në shtojcën 1 të kësaj shtojce;

c) me "mallra të importuara për qëllime sportive " do të kuptohet:

mallra të importuara për qëllim sportive: artikuj sportivë dhe materiale të tjera për t'u përdorur nga udhëtari gjatë konkurrimeve ose shfaqjeve sportive ose me qëllim stërvitjeje që do të kryhet në territorin e vendit të lejimit të përkohshëm. Një listë ilustruese të mallrave të tillë jepet në shtojcën II të kësaj shtojce.

#### KREU II

##### **Qëllimi**

##### Neni 2

Sendet dhe mallrat personale të importuara për qëllime sportive do të përfitojnë lejimin e përkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente.

#### KREU III

##### **Dispozita të ndryshme**

##### Neni 3

Për të përfituar nga lehtësirat e dhëna nga kjo shtojcë duhet që:

a) sendet personale duhet të importohen nga personi ose në bagazhin (nëse është ose jo i shoqëruar) e udhëtarit;

b) mallrat e importuara për qëllime sportive duhet të jenë në pronësinë e një personi të vendosur ose banues jashtë territorit të lejimit të përkohshëm, dhe duhet të importohen në sasi të arsyeshme në kuadër të qëllimit të përdorimit të tyre.

##### Neni 4

1. Lejimi i përkohshëm për sendet personale do të jepet pa pasur nevojë për dokument doganor ose garanci. Megjithatë, në rastin e artikujve që kanë një nivel të lartë të detyrimeve doganore dhe tatimeve, mund të kërkohet një dokument doganor dhe garanci.

2. Kur është e mundur, në vend të një dokument doganor ose garancie mund të pranohet një listë inventar i mallrave bashkë me një deklaratë me shkrim ku zotohet për të kryer rieksporimin.

##### Neni 5

1. Sendet personale do të rieksporoheshin jo më vonë se kur personi që i ka importuar ato largohet nga territori i lejimit të përkohshëm.

2. Periudha e rieksporimit të mallrave të importuara për qëllime sportive do të jetë të paktën 12 muaj nga data e lejimit të përkohshëm.

#### Neni 6

Shtesat e kësaj shtojce janë pjesë integrale e kësaj të fundit.

#### Neni 7

Me hyrjen në fuqi, kjo shtojcë, në përputhje me nenin 27 të kësaj Konvente, do të shfuqizojë dhe zëvendësojë zbatimin e nenit 2 dhe 5 të Konventës doganore për udhëtimin, Nju-Jork, 4 qershor 1954, në marrëdhëniet midis palëve kontraktuese të cilat kanë pranuar këtë shtojcë dhe që janë palë kontraktuese të kësaj Konvente.

### SHTOJCA I MJETE PERSONALE LISTA ILUSTRUESE

#### A. Mjetet personale të udhëtimit:

1. Veshja
2. Pajisje tualeti
3. Bizhuteri personale
4. Aparate fotografike të lëvizshme dhe statike së bashku me një masë të arsyeshme filmash dhe pjesët e tyre
5. Projektorë portative me diapozitiv ose film dhe pjesët e tyre, së bashku me një masë të arsyeshme diapozitivash ose filmash
6. Video-kamera dhe video regjistruar portative, me një masë të arsyeshme kasetash
7. Instrumente muzikore portative
8. Gramafon portative me disqe
9. Regjistruar dhe riprodhues zëri portative (përfshirë diktofonin), me kasete
10. Radiomarrës portativë
11. Aparate televizive portative
12. Makina shkrimi portative
13. Makina llogaritëse portative
14. Kompjuter personal portativë
15. Dylbi
16. Karrocë fëmijësh
17. Karrige me rrota për invalidë
18. Pajisje sportive të tilla si: tenda dhe pajime të tjera kampingu, pajime peshkimi, pajime alpinizmi, pajime zhytëse, armë zjarri sportive me municione, biçikleta të pamotorizuara, kanoe ose kajak jo më të gjatë se 5,5 metra, ski, raketa tenisi, tavolina sërifi, mjet fluturimi drejtuar me dorë dhe të tipit me krahë delta dhe pajime golfi.
19. Aparate analizash dhe të tjera mjekësore të ngjashme, dhe pjesët e duhura për përdorimin e tyre
20. Artikuj të tjerë të një natyre plotësisht personale.

### SHTOJCA II MALLRA TË IMPORTUARA PËR QËLLIME SPORTIVE LISTA ILUSTRUESE

#### A. Pajisje për atletike, të tilla si:

- pengesa,
- Shkop për hedhje së larti, disk, gjyle, shtize dhe çekiç.

#### B. Pajisje për lojërat me top, të tilla si:

- topa të llojeve të ndryshme,
- raketa, shkopinj për kroat, shkopinj golfi, shkopinj bejsbolli dhe të ngjashme me to,
- rrjeta të të gjitha llojeve,
- shtylla porte.

C. Pajime të sporteve dimërore, të tilla si:

- ski dhe shkopinj dallimi,
- patina për akull,
- slita bob,
- pajime për slitat dredhëse.

D. Veshje sportive, këpucë, dorashka, kaska, etj. të çdo lloji.

E. Pajime të sporteve ujore, të tilla si:

- kanoe dhe kajake,
- anije me vela dhe rrema, vela, rrema, rrema pa mbështetëse.

F. Mjete të motorizuara, të tilla si:

- makina,
- motorë,
- motobarka.

G. Pajime për veprimtari të ndryshme, të tilla si:

- armë sportive dhe municione,
- biçikleta të pamotorizuara,
- harqe shigjete dhe shigjeta,
- pajime gardhuese,
- pajime gjimnastikore,
- kompasë,
- tapet mundjeje dhe tatamis (shtroje me kashtë),
- pajime të peshëngritjes,
- pajime kalorësie, kaloshina,
- pajime alpinizmi,
- kaseta muzikore që shoqërojnë ushtrimin.

H. Pajisje ndihmëse, të tilla si:

- pajisje matjeje dhe tabela rezultatesh,
- aparate për testim gjaku dhe urine.

## SHTOJCA B.7

### SHTOJCË PËR MATERIALET PUBLICITARE TURISTIKE

#### KREU I

##### **Përcaktim**

##### Neni 1

Për qëllime të kësaj shtojce, me “materiale publiciteti turistik” do të kuptohet:

mallra që importohen për qëllim të nxitjes së publikut për të vizituar një vend tjetër të huaj, në veçanti për të ndjekur evenimente ose takime që zhvillohen aty për qëllime kulturore, fetare, turistike, sportive ose profesionale. Një listë ilustruese e një materiali të tillë jepet në shtesën e kësaj shtojce.

#### KREU II

##### **Qëllimi**

##### Neni 2

Përveç materiale të referuara në nenin 5 të kësaj shtojce, për të cilat jepet importim pa detyrime doganore të importit dhe taksa, materialeve publicitare turistike do të përfitojnë lejimin e përkohshëm në

përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente.

### KREU III

#### **Dispozita të ndryshme**

##### Neni 3

Për të përfituar lehtësitë e dhëna nga kjo shtojcë duhet që materiali turistik për publicitet të jetë në pronësi nga një person banues jashtë territorit të përjashtimit të përkohshëm dhe duhet të importohet në sasi të arsyeshme në kuadër të qëllimit të përdorimit të tyre.

##### Neni 4

Periudha për riekportim të materialit publicitar turistik do të jetë të paktën 12 muaj nga data e lejimit të përkohshëm.

##### Neni 5

Importim pa detyrime importi dhe taksa do të jepet për materialet publicitare të mëposhtme:

a) Dokumente (dosje, pamflete, libra, revista, udhëzues, postera me kornizë ose jo, fotografi dhe zmadhime fotografike, harta të ilustruara ose jo, fletë transparente të printuara) për shpërndarje falas, me kusht që këto dokumente nuk përmbajnë më shumë se 25 % të publiciteti komercial privat dhe është e qartë që janë për qëllime publiciteti të përgjithshëm;

b) Lista dhe publikime vjetore të hoteleve të huaja të publikuara ose të sponsorizuara nga agjenci zyrtare turistike dhe fletëoraret e shërbimeve të transportit që operojnë jashtë, nëse këto dokumente shpërndahen falas dhe nuk përmbajnë më shumë se 25 % publicitet komercial privat;

c) Materiale teknike, dërguar për përfaqësuesit ose korrespondentët e akredituar nga agjenci zyrtare kombëtare të turizmit, jo për t'u shpërndarë, si: publikime vjetore, numërorë telefonikë, lista hotelesh, katalogë panairesh, mostra të punimeve artizanale jo me vlerë të lartë, dokumente për muzeumet, universitetet, hotelet e banjave termale dhe institucione të ngjashme.

##### Neni 6

Shtojcat e kësaj shtojce janë pjesë integrale të këtij të fundit.

##### Neni 7

Me hyrjen në fuqi, kjo shtojcë, në përputhje me nenin 27 të kësaj Konvente, do të shfuqizojë dhe zëvendësojë protokollin shtesë të Konventës për turizmin, në lidhje me dokumentet dhe materiale publicitare turistike, 4 qershor 1954, në marrëdhëniet midis palëve kontraktuese të cilat kanë pranuar këtë shtojcë dhe që janë palë kontraktuese të kësaj Konvente.

### SHTOJCA

#### MATERIAL PUBLICITAR TURISTIK

#### LISTA ILUSTRUESE

1. Material me qëllim për të ekspozuar ne zyrat e përfaqësuesve ose korrespondenteve të akredituar të caktuar nga agjencitë kombëtare turistike ose në vende të aprovuara nga autoritetet doganore në Republikën e Shqipërisë: piktura dhe skica, fotografi në kornize dhe zmadhime fotografike, libra arti, piktura, gravura ose litografi, skulptura dhe tapiceri dhe punime arti të tjera të ngjashme me to.

2. Materiale publikuese (tabela treguese, stenda dhe artikuj të ngjashëm), përfshirë pajisjet elektrike dhe mekanike të nevojshme për veprimet e ekspozimit.

3. Filma dokumentarë, regjistrues, kaseta regjistruese dhe regjistrime të tjera zanore për përdorim të ekzekutimeve që janë falas, përjashtuar ato objektet e të cilave janë për përdorim reklamues tregtar dhe ato të cilat janë për shitje të përgjithshme në Republikën e Shqipërisë.

4. Një numër i arsyeshëm flamujsh.

5. Diorama, modele të zvogëluara, diapozitiv, blloqe printuese, negative fotografish.

6. Mostra, në një numër të arsyeshëm, të artikujve kombëtarë zejtarë, kostume popullore dhe artikuj të ngjashëm folklorikë.

## SHTOJCA B.8 SHTOJCË PËR MALLRAT E IMPORTUARA SI TRANSPORT KUFITAR

### KREU I

#### **Përcaktime**

##### Neni 1

Për qëllime të kësaj shtojce:

a) me termin "mallra të importuara si transport kufitar" do të kuptohen:

- ato mallra të marra nga banorët e zonës kufitare për ushtrimin e profesionit të tyre ose tregtinë (doktorë, artizanë, etj.);

- mjete personale ose shtëpiake të banorëve të zonës kufitare të importuara prej tyre për riparim, prodhim ose përpunim;

- pajisje me destinacion për t'u përdorur në punimin e tokës brenda zonës kufitare të territorit të lejitimit të përkohshëm;

- pajisje në pronësi të një enti zyrtar, importuar në lidhje me një operacion ndihme (zjarr, përmbytje, etj);

b) me termin "zonë kufitare" do të kuptohet:

një zonë e territorit doganor pranë kufirit tokësor, shtrirja e së cilës përcaktohet nga legjislacioni kombëtar, dhe kufizimet e së cilës shërbejnë për dalluar transportin kufitar nga llojet e tjera të transportit;

c) me termin "banorë të zonës kufitare" do të kuptohet: persona të vendosur ose rezidentë në një zonë kufitare;

d) me termin "transport kufitar" do të kuptohen: importimet e kryera nga banorët e zonës kufitare midis dy zonave kufitare përkatëse.

### KREU II

#### **Qëllimi**

##### Neni 2

Mallrave të importuara nëpërmjet transportit kufitar do t'u jepet lejimi i përkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente.

### KREU III

#### **Dispozita të ndryshme**

##### Neni 3

Për të përfituar lehtësitë nga kjo shtojcë duhet që:

a) mallrat e importuara si transport kombëtar duhet të jenë në pronësi të një banori të zonës kufitare fqinje me atë të lejitimit të përkohshëm;

b) pajisje për punimin e tokës duhet të përdoret nga banorët e zonës kufitare në fqinjësi me zonën kufitare të lejitimit të përkohshëm të cilët punojnë në tokën e zonës kufitare të dytë.

Këto pajisje duhet të përdoren për punë bujqësore ose për pylltari si shkarkim ose transport i drurit ose rritjen e peshkut;

c) transport kufitar për riparim, prodhim ose përpunim duhet të jetë qartësisht i një karakteri jo komercial.

##### Neni 4

1. Lejimi i përkohshëm i mallrave të importuara me transport kufitar do të jepet pa qenë nevoja e kërkesës për një dokument doganor ose garanci.

2. Secila prej palëve kontraktuese mund të autorizojë lejimin e përkohshëm të mallrave të



importuara me transport kufitar me kusht që të jepet një inventar i mallrave bashkë me një dokument me shkrim ku bëhet zotimi për t'i riekportuar ato.

3. Lejimi i përkohshëm mund të jepet gjithashtu në bazë të një deklarimi të thjeshtë në një regjistër të mbajtur nga dogana.

#### Neni 5

1. Periudha e riekportimit të mallrave të importuara nëpërmjet transportit kufitar do të jetë të paktën 12 muaj nga data e lejimit të përkohshëm.

2. Pajisje të destinuara për punimin e tokës do të riekportohen në momentin që puna është kryer.

### SHTOJCA B.9 SHTOJCË PËR MALLRAT E IMPORTUARA PËR QËLLIME HUMANITARE

#### KREU I

##### **Përkufizime**

##### Neni 1

Për qëllime të kësaj shtojce:

a) me termin "mallra të importuara për qëllime humanitare" do të kuptohet: pajisje mjekësore, kirurgjike dhe laboratorike dhe dërgesa për ndihmë;

b) me termin "dërgesa për ndihmë" do të kuptohet:

të gjitha mallrat si automjetet dhe mjete të tjera transporti, batanije, tenda, shtëpi të parafabrikuara ose mallra të tjera të nevojës jetësore të dërguara si ndihmë për njerëzit e prekur nga fatkeqësitë natyrore dhe katastrofa të ngjashme.

#### KREU II

##### **Qëllimi**

##### Neni 2

Mallrave të importuara për qëllime humanitare do tu jepet lejimi i përkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente.

#### KREU III

##### **Dispozita të ndryshme**

##### Neni 3

Për të përfituar lehtësitë nga kjo shtojcë duhet që:

a) mallrat e importuara për qëllime humanitare të jenë në pronësi të një personi të vendosur jashtë territorit të lejimit të përkohshëm dhe duhet të jepen falas;

b) pajisje mjekësore, kirurgjike dhe laboratorike me destinacion për t'u përdorur në spitale dhe institucione të tjera mjekësore, të cilat të ndodhura në rrethana të pazakonta kanë nevojë urgjente për to, me kusht që këto pajisje të mos jenë të disponueshme në sasi të mjaftueshme në territorin e lejimit të përkohshëm;

c) dërgesa me ndihma duhet t'u dërgohen personave të miratuar nga autoritetet kompetente në territorin e lejimit të përkohshëm.

#### Neni 4

1. Kur është e mundur, një inventar me mallrat, së bashku me një deklaratë me shkrim ku bëhet zotimi për rieksporim mund të pranohet për pajisje mjekësore, kirurgjike dhe laboratorike, në vend të një dokumenti doganor dhe garancie.

2. Lejimi i përkohshëm për dërgesat e ndihmës do të autorizohet pa qenë nevoja për një dokument doganor ose garanci. Megjithatë doganat mund të kërkojnë një inventar me mallrat së bashku me një deklaratë me shkrim ku bëhet zotimi për rieksporim.

#### Neni 5

1. Periudha e rieksporimit për pajisje mjekësore, kirurgjike dhe laboratorike do të përcaktohet sipas nevojave.

2. Periudha e rieksporimit të dërgesave me ndihma do të jetë të paktën 12 muaj nga data e lejimit të përkohshëm.

### SHTOJCA C SHTOJCË PËR MJETET E TRANSPORTIT

#### KREU I

##### **Përcaktime**

##### Neni 1

Për qëllime të këtij shtojce:

a) me termin "mjet transporti" do të kuptohet:

çdo mjet lundruar (përfshirë barkat dhe trapet dhe ato të transportuara në bordin e një anije, dhe hidrorrëshqitëset), aerorrëshqitëse, mjete ajrore, automjete (përfshirë motoçikletat, trailerat, gjysmëtrailerat dhe kombinacionet të automjeteve) dhe mjetet hekurudhore të lëvizshme; së bashku me pjesët normale të tyre të këmbimit, aksesorët dhe pajisjet që janë në bordin e mjeteve të transportit (përfshirë pajisje të veçanta për ngarkim-shkarkim, mbarëvajtjen dhe ruajtjen e ngarkesës);

b) me termin "përdorim komercial" do të kuptohet:

transporti i personave me pagesë ose transporti industrial dhe tregtar i mallrave nëse është ose jo me pagesë;

c) me termin "përdorim privat" do të kuptohet:

transporti që është ekskluzivisht për përdorim personal nga personi në fjalë duke përjashtuar përdorimin tregtar;

d) me termin "transport i brendshëm" kuptohet:

Transporti i personave ose mallrave të marrë ose ngarkuar në territorin e lejimit të përkohshëm të cilët do të kthehen ose shkarkohen brenda të njëjtit territor;

e) me termin "serbatorë normalë" do të kuptohet:

Serbatori i projektuar nga prodhuesi për të gjithë mjetet e transportit të të njëjtit lloj me mjetin e transportit në fjalë dhe vendosja e përhershme e të cilëve lejon përdorimin e drejtpërdrejt të një lloji të caktuar karburanti qoftë për lëvizjen e mjetit të transportit dhe për funksionimin gjatë transportit të sistemeve të ftohjes ose sistemeve të tjera. Serbatorët e instaluar në mjetin e transportit që lejojnë për t'u përdorur drejtpërdrejt me lloje të tjera karburanti dhe instaluar për sisteme të tjera do të konsiderohen si serbatorë normalë.

#### KREU II

##### **Qëllimi**

##### Neni 2

Lejimi i përkohshëm do të jepet për sa më poshtë në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente:

- a) mjete transporti për përdorim tregtar dhe privat;
- b) pjesët e këmbimit dhe pajisjet e importuara për riparimin e mjeteve të transportit të cilat janë të lejuara përkohësisht. Pjesë dhe pajisje të zëvendësuara të cilat nuk janë riekportuar do t'i nënshtrohen detyrimeve dhe taksave doganore përveç rasteve kur atyre i jepet një destinacion sipas nenit 14 të kësaj Konvente.

#### Neni 3

Veprimet rutinë të mirëmbajtjes dhe riparimet për mjetet e transportit të cilat nevojiten gjatë udhëtimit për në territorin e lejitimit të përkohshëm ose brenda tij dhe të cilat kryen gjatë periudhës së lejitimit të përkohshëm, nuk do të konsiderohen se përbëjnë një modifikim në kuptimin e nenit 1, paragrafi (a) i kësaj Konvente.

#### Neni 4

1. Karburanti i mbajtur në serbatorët normalë të mjeteve të transportit që janë lejuar përkohësisht si dhe vajrat lubrifikantë për përdorim normal të këtyre mjeteve të transportit do të pranohen pa detyrime dhe taksa doganore dhe pa zbatuar ndalimet ose kufizimet e eksportit.

2. Në rastin e automjeteve rrugore për përdorim tregtar, çdo palë kontraktuese do të ketë gjithsesi të drejtën të përcaktojë sasinë maksimale të karburantit të cilat mund të lejohen në territoret e tyre pa detyrime dhe taksa doganore dhe pa zbatuar ndalimet ose kufizimet në serbatorët normalë të automjeteve të tilla rrugore të lejuara përkohësisht.

### KREU III

#### **Dispozita të ndryshme**

#### Neni 5

Për të përfutur lehtësitë nga kjo shtojcë duhet që:

a) mjetet e transportit për përdorim tregtar duhet të jenë të regjistruara në një territor të ndryshëm nga ai i lejitimit të përkohshëm në emrin e një personi të vendosur ose banues në një territor të ndryshëm nga ai i lejitimit të përkohshëm dhe duhet të importohet dhe përdoret nga persona që operojnë në një territor të tillë;

b) mjete transporti për përdorim privat duhet të regjistrohet në një vend të ndryshëm nga ai i lejitimit të përkohshëm, në emër të një personi të vendosur ose banues në një territor të ndryshëm nga ai i lejitimit të përkohshëm dhe duhet të importohet dhe përdoret nga persona banues në një territor të tillë.

#### Neni 6

Lejimi i përkohshëm do të jepet pa qenë nevoja për të kërkuar një dokument doganor ose garanci.

#### Neni 7

Pavarësisht dispozitave të nenit 5 të kësaj shtojce:

a) mjetet e transportit për përdorim tregtar mund të përdoren nga persona të tretë, edhe nëse janë të vendosur ose banues në territorin e lejitimit të përkohshëm kur janë të autorizuar përkatësisht nga personat që u është dhënë lejimi i përkohshëm dhe veprojnë në emër të tyre;

b) mjetet e transportit për përdorim privat mund të përdoren nga personat e tretë të cilët janë të autorizuar përkatësisht nga personat të cilëve u është dhënë lejimi i përkohshëm. Çdo palë kontraktuese mund të lejojë përdorimin nga një person banues në territorin e saj, sidomos kur mjete të transportit përdoren në emër të dhe sipas udhëzimeve të personit të cilit i është dhënë lejimi i përkohshëm.

#### Neni 8

Çdo palë kontraktuese ka të drejtë të refuzojë ose revokojë përfitimet nga lejimi i përkohshëm për:

- a) mjetet e transportit për përdorim tregtar të cilat përdoren në transportin e brendshëm;
- b) mjetet e transportit për përdorim privat të cilat përdoren për përdorim tregtar në transportin e

brendshëm;

c) mjetet e transportit të dhëna me qira pas importimit ose nëse janë importuar të marra me qira, rimerren me qira ose jepen përsëri me qira për një qëllim të ndryshëm nga ai i riekportimit të menjëhershëm.

#### Neni 9

1. Mjetet e transportit për qëllime tregtare do të riekportohen në momentin kur janë kryer veprimet e transportit për të cilat ato ishin importuar.

2. Mjetet e transportit për përdorim privat mund të qëndrojnë në territorin e lejjimit të përkohshëm për një periudhë, në vazhdimësi ose jo, prej gjashtë muajsh në çdo periudhë prej 12 muajsh.

#### Neni 10

Çdo palë kontraktuese gëzon të drejtën që të paraqesë rezerva, në përputhje me nenin 29 të kësaj Konvente në lidhje me:

a) nenin 2, nënparagrafi (a), për sa u përket automjeteve rrugore dhe mjeteve të lëvizshme hekurudhorë;

b) nenin 6, për sa u përket automjeteve rrugore për përdorim tregtar dhe mjeteve të transportit për përdorim privat;

c) nenin 9, paragrafi 2 të kësaj shtojce.

#### Neni 11

Me hyrjen në fuqi, kjo shtojcë, në përputhje me nenin 27 të kësaj Konvente, do të shfuqizojë dhe zëvendësojë Konventën doganore për lejjimin e përkohshëm të automjeteve rrugore Nju-Jork 4 qershor 1954, Konventën doganore për lejjimin e përkohshëm, Gjenevë, 18 maj 1956, Konventën doganore për lejjimin e përkohshëm, Gjenevë, 18 maj 1956, për përdorim të mjeteve ajrore dhe lundruese për argëtim në marrëdhëniet midis palëve kontraktuese të cilat kanë pranuar këtë shtojcë dhe që janë palë kontraktuese të kësaj Konvente.

### SHTOJCA D SHTOJCË PËR KAFSHËT

#### KREU I

#### **Përkufizime**

##### Neni 1

Për qëllime të kësaj shtojce:

a) me termin "kafshë" do të kuptohen: kafshë të gjalla të çdo specieje;

b) me termin "zonë kufitare" do të kuptohet: një zonë e territorit doganor pranë kufirit tokësor, shtrirja e së cilës përcaktohet në legjislacionin kombëtar dhe kufizimet e tyre shërbejnë për të dalluar transportin kufitar nga transporte të llojeve të tjera;

c) me termin "banor të zonës kufitare" do të kuptohet: personi i vendosur ose banues midis dy zonave fqinje kufitare;

d) me termin "transport kufitar" do të kuptohet: importimi i kryer nga banorët e zonës kufitare midis dy zonave fqinje kufitare.

#### KREU II

#### **Qëllimi**

##### Neni 2

Kafshët e importuara për qëllimet e specifikuara në shtesën e kësaj shtojce do të përfitojnë nga lejimi i përkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente.

### KREU III

#### **Dispozita të ndryshme**

##### Neni 3

Për të përfituar lehtësitë nga kjo shtojcë duhet që:

- a) kafshët të jenë në pronësi të një personi të vendosur ose banues jashtë territorit të lejimit të përkohshëm;
- b) të jenë kafshë pune që përdoren për punimin e tokës që është në zonën kufitare të një territori të lejimit të përkohshëm duhet të importohen nga banorët e zonës kufitare fqinje me atë të lejimit të përkohshëm.

##### Neni 4

1. Lejimi i përkohshëm për kafshët e punës referuar në nenin 3 (b) të kësaj shtojce, dhe kafshët e importuara për ndërrim kullote apo për kullotje në tokën që ndodhen në zonën kufitare do të jepet pa qenë nevoja e një dokumenti doganor ose garancie.

2. Çdo palë kontraktuese mund të autorizojë lejimin e përkohshëm të kafshëve referuar në paragrafin 1 të këtij neni në bazë të vënies në dispozicion të një inventari, së bashku me një deklaratë me shkrim ku bëhet zotimi për rieksporim.

##### Neni 5

1. Çdo palë kontraktuese gëzon të drejtën të paraqesë një rezervë në përputhje me nenin 29 të kësaj Konvente në lidhje me nenin 4, paragrafi 1 të kësaj shtojce.

2. Çdo palë kontraktuese gëzon edhe të drejtën për të paraqitur një rezervë në përputhje me nenin 29 të kësaj Konvente, në lidhje me pikat 12 dhe 13 të shtesës së kësaj shtojce.

##### Neni 6

Periudha për rieksporimin e kafshëve do të jetë të paktën 12 muaj nga data e lejimit të përkohshëm.

##### Neni 7

Shtesat e kësaj shtojce janë pjesë integrale të këtij të fundit.

### SHTOJCA

#### LISTA SIPAS NENIT 2

1. Stërvitje (e kuajve)
2. Trajnim
3. Mbarështim
4. Mbathja ose peshimi i kofshëve
5. Trajtim veterinar
6. Testim (për shembull, për qëllime shitjeje)
7. Pjesëmarrje në shfaqje, ekspozita, konkurse, ose demonstrime
8. Zbavitje (kafshët e cirkut, etj.)

9. Turizëm (përfshirë kafshët shtëpiake për udhëtarët)
10. Ushtrim funksioni (qentë ose kuajt e policisë; qen zbulimi, qen për të verbrit, etj.)
11. Operacione shpëtimi
12. Nxjerrja në kullotë
13. Për qëllime transporti ose pune
14. Për qëllime mjekësore (shpërndarje të helmit të gjarpërinjve, etj.)

**SHTOJCA E**  
**SHTOJCË PËR MALLRAT E IMPORTUARA ME PËRJASHTIM TË PJESSHËM TË DETYRIMEVE**  
**TË IMPORTIT DHE TË TAKSAVE**

**KREU I**

**Përcaktime**

Neni 1

Për qëllime të kësaj shtojce :

a) me termin "mallra të importuara me përjashtim të pjesshëm" do të kuptohen: mallra të cilat importohen në shtojcat e tjera të kësaj Konvente, por që nuk përmbushin të gjitha kushtet e parashtruara këtu për autorizimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet dhe taksat doganore dhe mallra që nuk përmenden në të tjera shtojca të tilla dhe të cilat importohen për përdorim të përkohshëm, për shembull ekzekutimin e projekteve të punës;

b) me termin "përjashtim i pjesshëm" do të kuptohet: përjashtim nga pagesa e një pjese ose totali i shumës së detyrimeve doganore dhe taksave të cilat do të paguheshin nëse mallrat do të zhdoganoheshin për përdorim brenda vendit në datën në të cilën u vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

**KREU II**

**Qëllimi**

Neni 2

Mallrave të referuar në nenin 1, paragrafi "a" të kësaj shtojce do t'u jepet lejimi i përkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente.

**KREU III**

**Dispozita të ndryshme**

Neni 3

Për të përfituar nga lehtësitë që jepen nga kjo shtojcë, mallrat e importuara, me përjashtim të pjesshëm, duhet të jenë në pronësi të një personit të vendosur ose banues jashtë territorit të lejimit të përkohshëm.

Neni 4

Çdo palë kontraktuese mund të përpilojë një listë mallrash të cilat mund të gëzojnë ose jo të drejtën e përfitimit nga lejimi i përkohshëm me përjashtim të pjesshëm. Depozituesi do të njoftohet për përmbajtjen e kësaj liste.

Neni 5

Shuma e detyrimeve dhe taksave të importit të vendosura sipas këtij regjimi nuk mund të kalojë 5 %, për çdo muaj ose fraksion muaji gjatë së cilit mallrat vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

#### Neni 6

Shuma e detyrimeve të importit dhe taksave që do të vihen në asnjë rast nuk do të kalojë atë shumë që do të kishin mallrat në rast se ato do të zhdoganoheshin për t'u përdorur brenda vendit në datën në të cilën u vendosën nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

#### Neni 7

1. Shuma e detyrimeve të importit dhe taksave të pagueshme sipas kësaj shtojce do të mbliidhen nga autoritetet kompetente kur të mbyllet procedura.

2. Kur, në përputhje me nenin 13 të kësaj Konvente, procedura e lejimit të përkohshëm përfundon duke bërë zhdoganim për qarkullim brenda vendit, shumën e çdo detyrimi dhe takse doganore të ngarkuara gjatë përjashtimit të pjesshëm, do të zbriten nga shuma e detyrimeve të importit dhe taksave që do të paguhen si rezultat i zhdoganimit për përdorim brenda vendit.

#### Neni 8

Periudha e riekportimit të mallrave të importuara me përjashtim të pjesshëm do të përcaktohet duke marrë parasysh dispozitat e neneve 5 dhe 6 të kësaj shtojce.

#### Neni 9

Çdo palë kontraktuese do të ketë të drejtën të paraqesë rezerva në përputhje me nenin 29 të kësaj Konvente, në lidhje me nenin 2 të kësaj shtojce, për deri sa ka të bëjë me përjashtimin e pjesshëm nga taksat e importit.